




KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

**RAPORT VJETOR 2020**

**Korporata Energjetike e Kosovës**

## **Përmbajtja e Raportit**

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
<b>RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE .....</b>	<b>6</b>
Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes .....	6
Informacion lidhur me Kapitalin dhe Devidendën.....	7
Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv .....	8
<b>RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES .....</b>	<b>10</b>
Ngjarjet Kryesore të vitit 2020.....	10
Burimet Njerëzore.....	13
Departamenti i Mjedisit .....	14
Siguria Fizike.....	14
Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës.....	15
Indikatorët kyç të Performancës për vitin 2020 .....	15
Divizioni i Mihjeve .....	15
Divizioni i Gjenerimit.....	17
<b>PERFORMANCA FINANCIARE .....</b>	<b>18</b>
Pasqyra e të ardhurave .....	19
Faktorë tjerë që ndikojnë në të hyrat.....	21
Pasqyra e shpenzimeve.....	22
Gjendja e Kompanisë .....	24
Progresi i Projekteve Kapitale .....	25
Shpenzimet kapitale dhe projektet .....	25
Divizioni i Mihjeve .....	26
Divizioni i Gjenerimit të Energjisë.....	26
Divizioni i Shërbimeve të Korporatës.....	27
<b>PLANI I BIZNESIT DHE PERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM .....</b>	<b>28</b>
Ambienti.....	30
Plani i Divizionit të Mihjeve .....	31
Plani i Divizioneve të Gjenerimit të Energjisë .....	31
Ndikimet e Jashtme në Planin e Biznesit .....	32
<b>MENAXHIMI I RREZIQEVE TË KORPORATËS .....</b>	<b>34</b>
Identifikimi i rreziqeve .....	35
Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të çmimeve.....	38
Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të kreditimit.....	39
Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të likuiditetit.....	39
<b>RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN .....</b>	<b>40</b>
Qeverisja korporative .....	40
Funksionimi i kontrolleve të brendshme .....	41
Zyra e Auditimit të Brendshëm .....	42
Përmbledhja e të gjitha procedurave gjyqësore .....	44
Transaksionet e Konsiderueshme .....	45
Raportet me KPMM dhe Institucionet tjera .....	45
<b>SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR TË ARDHMEN .....</b>	<b>46</b>
<b>STRUKTURA ORGANIZATIVE KEK SH. A 2020 .....</b>	<b>49</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE .....</b>	<b>50</b>



## FAKTE KYÇE

**Të hyrat**

**EBITDA\***

**Fitimi neto**

**Prodhimi**

**CAPEX/OPEX**

31 Dhjetor 2020

**193,02 mln**

Të hyrat e vitit 2020 janë realizuar nga shitja e energjisë, thëngjillit, nga kon gjenerimi dhe te hyra te tjera.

**67,44 mln**

EBITDA është kalkuluar në 67.44 milion. Përfshin Fitimin para tatimit dhe interesit duke shtuar amortizimin dhe duke hequr zërat jo para të gatshme

**23,78 mln**

Fitimi para tatimit i vitit tregon performancën financiare e pa korigjuar për efektet e regjistrimeve dhe vlerësimeve kontabël të fund vitit

**5,98 million MWh**

Energjia elektrike e prodhuar 5,98 milion MWh neto ose 8% mbi plan Thëngjilli 8,54 milion ton 2020 ose 99,8 % krahasuar me planifikim Djerrina 11,6 milion ton ose 89,4% e planit

Capex i paguar është 36,9milion Euro apo 19,1% e të hyrave të realizuara. Ndërsa shpenzimet operative janë 162,55 milion euro



■ Të hyrat ■ Capex

**+4.26%**

Të hyrat e realizuara në vitin 2020 janë për 4.26% me te larta se të hyrat e realizuara në vitin 2019.

**+12.19%**

EBITDA është rritur në 2020 me 12.19% nga viti është 2019, ku ishte 60.1 milion


**+23.73 %**

Fitimi neto paraqet rritjen konstante te kompanisë me 4.5 milion euro në 2020, e cila paraqet rritje për 23.73 % të fitimit vjetor të korporatës krahasuar me 2019

2020 vs 2019

\*Fitimi para tatimit dhe interesit (+) zhvlerësimi dhe amortizimi (-) zhvlerësim dhe amortizim i granteve (-) Urimi i provizioneve/Provizionet për shlyerjen e inventarit (+) Humbjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve (-) Ndryshimet në provizione

### Koeficientet financiar



## Përmbledhje ekzekutive

Viti 2020 do të mbahet mend si vit i pandemisë dhe aktiviteteve për menaxhimin e saj, me fokus drejt mbrojtjes të shëndetit të punonjësve. Ishtë një sfidë unike me të cilë u përball vendi dhe i gjithë globi, pasojat e së cilës ishin të rënda edhe pse ende jo totalisht të njohura. Kjo bëri që, krahas nevojës së domosdoshme të realizimit të prodhimit, qëllimi kryesor i menaxhmentit të jetë mbrojtja e shëndetit të punëtorëve. Ende më të vështirë e bëri mbyllja totale e vendit për disa muaj, kufizimi në lëvizje, rreziqet për shëndetin e punëtorëve dhe të tjera, që dhanë efekte në vonesat në realizimin e projekteve strategjike dhe rritje të shpenzimeve. Megjithatë, viti 2020 për KEK, fal angazhimit të madh të punëtorëve, u mbyll me një performancë të mirë operative dhe financiare. Prodhimi u realizua pa probleme të theksuara, dhe me rezultate rekorde duke kapur shifrën bruto 6.62 milion MWh energji elektrike, më e larta e prodhuar ndonjëherë nga termocentralet e KEK-ut, përgjatë operimit të tyre që nga viti 1962. Ndërsa, prodhimi i thëngjillit poashtu është rritur si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për konsum të brendshëm/lëndë të parë në 8.54 milion ton në vitin 2020.

E gjithë kjo u pasqyrua në një performancë të jashtëzakonshme financiare, duke arritur fitimin vjetor, pas tatimit, në shumë €23.78 milion. Kjo përbën një arritje të madhe për qëndrueshmërinë afatgjatë financiare, dhe një shtysë e mirë që investimet e planifikuara të mund të realizohen konsiderueshëm nga burime të brendshme financimi.

Korporata Energjetike e Kosovës, si prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në vend, vazhdon të jetë kontribues në zhvillimin ekonomik të vendit. Në fund të vitit 2020 kishte të angazhuar 3,887 punëtorë, të cilëve, përkundër vështirësive dhe moshës së shtyer (mosha mesatare e punëtorëve arrin 53 vjeç) KEK ua atribuon suksesin e vet. Prandaj, KEK në vazhdimësi është duke u punuar për përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së punëtorëve në bashkëpunim me sindikatat dhe në përputhje me mundësitë ligjore.

KEK krahas qëllimit të vet për stabilitet të prodhimit të energjisë vazhdon ta ketë në fokus komunitetin, ku përmes projekteve të veta afatgjata synon që të ndihmoj ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës. Megjithatë, pandemia goditi këto objektiva të korporatës, duke shtyer në kohë realizimin e projekteve të BE për elektrofiltrat vitet 2022/2023, bashkë me të cilat u shtyen edhe disa investime të KEK-ut për zgjatjen e jetëgjatësisë



së aseteve të veta. Poashtu tërheqja e Contour Global nga projekti i Kosovës së Re, ka hap rrugë për një dimension të ri të zhvillimit në sektorin e energjisë, duke bërë të nevojshme rishikimin e strategjisë së Qeverisë së Kosovës për energjinë e cila pashmangshëm ndikon në aktivitetet afatgjata të korporatës.




Gjatë 2020 është vazhduar me realizimin e projekteve që ndërlidhen me hapjen e Minierës së Re sipas raportit të Mibrag dhe poashtu janë në proces investime strategjike në TCB duke mos lënë anash edhe projektet e mirëmbajtjes në TCA, të cilat kanë kryesisht impakt në sigurimin e vazhdimin të operimit të blloqeve ekzistuese në gjendje optimale deri në një vendim tjetër strategjik në bashkëpunim me Aksionarin.

Përkundër të gjitha vështirësive, KEK ka vazhduar me aktivitetet të fazës fillestare për instalimi e pajisjeve për prodhim të energjisë nga burime të ripërtrishme, ku gjatë vitit 2020 ka përfunduar studimin e fizibilitetit dhe ka zhvilluar disa takime me aksionarin (ME) dhe aktivitete për marrjen e mbështetjes nga burime të jashtme të financimit për parkun solar, fillimisht me 100 MWh.

Fare në fund, ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ MF nr. 07/2019 për Strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raportimeve financiare vjetore. Informacioni i mëposhtëm duhet të lexohet së bashku me Pasqyrat Financiare dhe shënimet shpjeguese të bashkangjitura në fund të këtij raporti.

Raporti paraqet aktivitetet dhe gjendjen e korporatës në vitin 2020, të cilat me një vështrim në perspektivë, nën hijen e pandemisë pritshmëritë për rezultatet e vitit 2021 janë të paqarta, megjithatë TM 1 tregon për një vazhdimin të trendit pozitiv të rezultateve financiare.

Megjithatë, pavarësisht sfidave, menaxhmenti i KEK-ut i angazhohet pa rezerva në përmbushjen e misionit të korporatës që të realizoj prodhimin stabil të energjisë elektrike me kosto sa më të ulët dhe me ndikim minimal në ndotjen e ambientit, duke punuar me profesionalizëm dhe sjellje etike.

Emri	Përgatitur nga	Aprovoi	Aprovoi
	Gazmend Amxheqaj Drejtor Ekzekutiv Financiar KEK ShA	Përparim Kabashi UD. Drejtor Menaxhues KEK ShA	Rrezarta Pllana Kryesuese e BtD KEK ShA
Nënshkrimi			
Datë:	Maj 2021	Maj 2021	Maj 2021

# Raporti I Bordit të Drejtorëve

## *Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes*

Përcjellja dhe mbikëqyrja e realizimit të planeve operative dhe kapitale të ndërmarrjes ishin aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve. Poashtu, bordi është marrë në vazhdimësi me shqyrtimin e performacës financiare dhe operative të korporatës, kryesisht gjatë takimeve të rregullta. Në këtë drejtim, është përkrahur edhe nga puna e komisioneve të ndryshme në nivel të bordit dhe kryesisht nga Komisioni i Auditimit. Performanca operative dhe financiare gjatë vitit 2020 ka shënuar ngritje në krahasim me vitin paraprak.



Rezultate të mira të arritura për vitin e kaluar janë shoqëruar edhe me adresimin e çështjeve të ngritura nga auditorët në Letër Menaxhmentin e vitit paraprak, në mënyrë që pritjet për një opinion të pakualifikuar për Pasqyrat Financiare për vitin 2020, të jenë realiste. Edhe raportet tremujore dhe vjetore janë miratuar gjatë vitit, sipas kërkesës së ligjit për ndërmarrjet publike dhe janë përcjellë për informim tek Aksionari.

Paralelisht me këto rezultate, Bordi i Drejtorëve (BtD) është angazhuar në zbatimin e vendimeve të aksionarit për Projektin Kosova e Re, për ndërtimin e kapacitetit të ri të gjenerimit, ashtu si parashihet në strategjinë kombëtare të zhvillimit, që është në fuqi nga viti 2016. Megjithatë, me tërheqjen e Contour Global nga procesi i ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, për KEK u krijua një situatë e re ku kërkohej rishikimi i prioritetëve dhe kohës së investimeve, në mënyrë që të mund të arrihej qëllimi i vet, prodhimin e energjisë me kosto efektive dhe stabilitet në prodhim të energjisë. Si përgjigje ndaj kësaj shtate, në pritje edhe të ndryshimit të strategjisë së Qeverisë së Kosovës për Energjinë, gjatë vitit 2020 me kërkesë të BtD u themelua grupi për rishikimin e planeve zhvillimore të KEK për 2021-2025 si dhe u mor vendim për fillimin e procedurave për studimin e fizibilitetit për TC Kosova A. Në kuadër të aktivitetëve të tjera që lidhen me performancën e ndërmarrjes dhe me aktivitetet e BtD gjatë vitit 2020 u nënshkrua kontrata për angazhimin e një kompanie konsulente për rishikimin funksional të skemës organizative e cila ndër të tjera ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të kompanisë.

Në këtë drejtim, Bordi i drejtorëve ka qenë i përfshirë në takime me nivele të ndryshme të Qeverisë së Kosovës, përfshirë kryeministrin, si dhe me institucione ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe USAID. Lidhur me projektin e shthurjes, i iniciuar konform strategjisë energjetike 2005 – 2015, i vazhduar me vonë edhe me vendimet e Qeverisë së Kosovës dhe rekomandimeve të NjMNP, dhe Vendimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2017, nuk ka patur vazhdim të procesit duke qenë se projekti i ndërtimit të kapacitetit të ri gjenerues nga qymyri ka ngecur pas tërheqjes së kompanisë të përzgjedhur nga Qeveria.

## Informacion lidhur me Kapitalin dhe Dividendën

Gjatë vitit 2020 si rezultat i rritjes së performancës financiare, kompania ka rrit kapitalin e vet në kuadër të rritjes së vlerës për investimet e realizuara dhe nga operimet e saj. Kapitali i kompanisë ka shënuar rritje nga 153.4 në 2019 në 177.41 milion € në vitin 2020, duke reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së kapitalit/detyrime 37% me 63% në 2019, në 58% detyrime dhe 42 % kapital në 2020.



Megjithëse ka një strukturë të madhe financimi me borxh, ndërmarrja ka treguar aftësi financiare për të shlyer detyrimet e veta financiare ndaj kreditorit të vet, i cili në rastin e KEK është vet aksionari i saj. Ndërmarrja nuk ka nënshkruar kredi të re për këtë vit, kurse për kreditë e marra në vitet 2008-2012 është arritur marrëveshja me Ministrinë e Financave gjatë vitit 2015, për ri-programin e tyre dhe është duke vazhduar edhe këtë vit pagesat në bazë të marrëveshjes. Gjatë vitit 2020 janë shlyer kësti i huamarrjes €11.39 milion dhe interesi i kalkuluar prej € 664 mijë.

	2020 (në €' 000)	2019 (në €' 000)
<b>Pjesa afatgjatë</b>		
Kredia e MF që bart interes	138,154	149,541
	<b>138,154</b>	<b>149,541</b>
<b>Pjesa afatshkurtër</b>		
Remonti dhe Rehabilitimi i Kosova A dhe B		-
Hapja dhe operacionalizimi i Minierës së Sibovci JP.		-
Kredia Interes bartëse nga MF –Pjesa afatshkurtër	11,387	11,387
Interesi Akruar (jo i vonuar)	664	622
	<b>12,051</b>	<b>12,009</b>
<b>Total huazimet</b>	<b>150,205</b>	<b>161,550</b>

*Përkundër konsolidimit të pozitës financiare, edhe këtë vit korporata nuk ka planifikuar të ndaj dividendë për Aksionarin, për shkak të planeve për zgjerim dhe për rritjen e stabilitetit të prodhimit të energjisë elektrike, si obligime që burojnë nga Strategjia për energji e Qeverisë së Republikës së Kosovës.*

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka paguar për realizimin e investimeve kapitale në vlerën prej €36.9 milionë. Ndër këto investime, të rëndësishme janë ato në përmirësimin e ndikimit mjedisor nga termocentralet, investimet në TC Kosova A, në Divizionin e Mihjeve si dhe në TC Kosova B .

### ***Të dhënat për Drejtorët Jo-Ekzekutiv***

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, aksionari në këtë rast Qeveria e Republikës të Kosovës emëron dhe shkarkon anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore. Mbi këtë bazë, me vendimin nr. 10/13, të dt 10.11.2017, Aksionari ka emëruar:

1. z. Faruk Hajrizi, drejtor jo-ekzekutiv dhe Kryesues;
2. znj. Fllanza Beqiri-Hoxha drejtoreshë jo-ekzekutive;
3. z. Izet Ibrahim, drejtor jo-ekzekutiv;
4. z. Mehdi Pllashniku, drejtor jo-ekzekutiv;
5. z. Gjelo Vataj, drejtor jo-ekzekutiv.

Ndërsa, Komisionin e Auditimi me këtë përbërje:

1. znj. Fllanza Beqiri-Hoxha, Kryesues;
2. z. Izet Ibrahim, Anëtar;
3. z. Gjelo Vataj, Anëtar.

Pastaj, me vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës nr.01/26, dt 23.04. 2020 është emëruar Bordi i ri i përkohshëm me këtë përbërje:

1. Znj Rrezarta Pllana, drejtor jo-ekzekutiv dhe Kryesues
2. Z. Arbnor Pula drejtor jo-ekzekutiv
3. Z. Merita Kasapolli drejtor jo-ekzekutiv
4. Z. Beza Halilaj drejtor jo-ekzekutiv

Ndërsa, Komisionin e Auditimi me këtë përbërje:

1. z. Beza Halilaj, Kryesues;
2. Znj. Merita Kasapolli, Anëtar;
3. z. Arbnor Pula, Anëtar.

Pastaj, me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/19, dt 3.08.2020 është emëruar Bordi i ri i përkohshëm me këtë përbërje:

1. Z. Hysen Fazliu, drejtor jo-ekzekutiv dhe Kryesues;
2. Znj. Fatime Grajqevci, drejtor jo-ekzekutiv;
3. Z. Petrit Ibraj, drejtor jo-ekzekutiv;
4. Z. Egzon Berisha drejtor jo-ekzekutiv.



Ndërsa, Komisionin e Auditimi me këtë përbërje:

1. z. Petrit Ibraj, Kryesues;
2. Znj. Fatime Grajcevc, Anëtar;
3. Z. Egzon Berisha Anëtar.

Pastaj, me vendimin e Qeverise se Kosovës nr.01/37, dt 24.10.2020 është emëruar Bordi i ri i përkohshëm me këtë përbërje:

1. Z. Musa Misini - drejtor jo-ekzekutiv, Kryesues;
2. Z. Petrit Ibraj - drejtor jo-ekzekutiv;
3. Znj. Fatime Grajcevc - drejtor jo-ekzekutiv;
4. Z. Fadil Hoxha - drejtor jo-ekzekutiv.

Ndërsa, Komisionin e Auditimi me këtë përbërje:

1. z. Petrit Ibraj, Kryesues;
2. Znj. Fatime Grajcevc, Anëtar;
3. Z. Fadil Hoxha, anëtar.

Pas skadimit të mandatit të bordit të përkohshëm dt 24.04.2021, me vendimin e Qeverise se Kosovës nr.09/12, dt 21.05.2021 është emëruar Bordi i ri i përkohshëm me këtë përbërje:

1. Znj Rrezarta Pllana, drejtor jo-ekzekutiv dhe Kryesuese
2. Z. Beza Halilaj drejtor jo-ekzekutiv
3. Z. Arbnor Pula drejtor jo-ekzekutiv
4. Z. Merita Kasapolli drejtor jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2020, janë mbajtur 21 takime të Bordit dhe 10 takime të Komisionit të Auditimit. Mbledhja e përgjithshme vjetore e Aksionarit është mbajtur me dt. 23.09.2020. Në kuadër të Bordit të Drejtorëve gjatë 2020 nuk kanë vepruar komitete te përkohshme.

Kompensimi i anëtarëve jo-ekzekutiv është realizuar konform ligjit për ndërmarrjet publike (ligji 03/L-87, neni 20) dhe vendimit të Aksionarit nr. 07/81, dt 23-03-2016. Gjatë këtij viti nuk është paguar kompensim për stimulimin e efektshmërisë në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimin e cila përgatitet dhe zbulohet nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 20, të ligjit të lartë apostrofuar.

## RAPORTI I DREJTORIT MENAXHUES

### *Ngjarjet Kryesore të vitit 2020*

KEK-u ka një mision specifik që të ofrojë shërbime të sigurta, të besueshme dhe me çmime të arsyeshme të energjisë elektrike, por gjithashtu edhe të jetë e përgjegjshme ndaj ambientit dhe financiarisht e qëndrueshme. Gjatë vitit 2020, Korporata Energjetike e Kosovës ka funksionuar në përputhje me planet e saja duke arritur një performancë të mirë dhe në tejkalimin e planifikimit të prodhimit të energjisë elektrike sipas Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike (BVEE), duke rritur të hyrat e përgjithshme financiare për korporatën dhe përtej saj duke regjistruar një rekord të prodhimit të energjisë elektrike në histori të KEK-ut.

Si vit i karakterizuar pandemia globale COVID 19, e cila ka sfiduar edhe funksionimin e Korporatës Energjetike të Kosovës. Mirëpo, me anë të profesionalizmit dhe përkushtimit të punëtorëve dhe veprimeve të ndërmarra nga Menaxhmenti i kompanisë kjo situatë është menaxhuar mirë, sipas udhëzimeve të IKSHPK dhe vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për fat të keq, 5 punonjës të ndërmarrjes kanë humbur jetën nga COVID-19.

Në aspektin e realizimit të projekteve kapitale, pandemia COVID 19 ka pasur efekt negativ, siç janë remonti kapital i njesisë A4 po ashtu shtyja e shumë projekteve të tjera duke përfshirë edhe projektin e financuar nga BE nëpërmjet fondeve IPA për ndërrimin e ESP dhe zvogëlimin e DE-NoX-it në TC Kosova B.

Gjatë viti 2020, jemi përballur edhe me shpronësime të tokave dhe pronave që i hapin rrugë eksploatimit të qymyrit për furnizim të Termocentraleve. Ky proces është menaxhuar në mënyrën me të mirë të mundshme krahasuar me të kaluarën, duke përmbyllur projektin 52ha dhe realizimin rreth 60% të projektit 129ha.

Janë marrë masa në funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme ku janë lëshuar tridhjetë (30) Urdhëresa Ekzekutive me qëllim rregullimin e aktiviteteve të brendshme të funksionimit të korporatës ose edhe për respektimin e kërkesave ligjore ose vendime të institucioneve të ndryshme. Poashtu, Zyra Ekzekutive për Përputhshmëri Institucionale dhe Organizative ka iniciuar 27 lëndë të natyrës së kontrolleve të brendshme dhe nga to 25 raporte janë publikuar dhe janë duke u trajtuar së bashku me menaxhmentin, në rritjen e cilësisë dhe mirë funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Gjatë vitit 2020, me kërkesë të KOSTT, KEK ka asistuar në pavarësimin e sektorit të energjisë, ku me anëtarësimin në ENTSO-E, KOSTT luan rolin e vet në bllokun rregullues të pavarur energjetik.

Gjatë këtij viti janë realizuar një sërë marrëveshesh bilaterale si:

- Amendamenti nr.1. i marrëveshjes se inkasimit me KEDS/KESCO për borxhet e vjetra (para 05/2013);
- Amendamenti i marrëveshjes për furnizim me shumicë për çmimet e furnizimit me shumicë për KEDS dhe KESCO për periudhën 01 Prill 2020 deri 31 Mars 2021;
- Marrëveshja për çmimet e furnizimit me shumicë për KOSTT për periudhën 01 Prill 2020 deri 31 Mars 2021;
- Marrëveshja mes KEK-ut dhe KOSTT-it për shërbimet ndihmese për periudhën Tetor - Dhjetor 2020;
- Është arritur marrëveshje miqësore për zgjidhjen e kontestit KEK - EthosEnergy, vlera e kontestit të bartur që nga viti 2014 ishte €1.3 milion;
- Është nënshkruar marrëveshja për çmime për furnizimin me energji termike të TERMOKOS për periudhën Tetor 2020- Prill 2021.

Edhe për kundër sfidave të përmendura viti 2020 ishte vit i realizimit të objektivave të parapara në planin e biznesit si dhe përmirësimit të parametrave kyç të korporatës. KEK vazhdon të jetë një korporatë financiarisht e vet-qëndrueshme, kompani likuide dhe ka vazhduar të investojë në projekte kapitale me mjete vetanake, në kapacitetet e saja prodhuese dhe gjeneruese të energjisë elektrike, si dhe investime kapitale në përmirësimin e ambientit për të cilat synohet që të vazhdohet edhe në vitet në vijim. Janë nënshkruar kontrata për investime në divizionin e mihjeve dhe njësitë gjeneruese.

Është eksportuar energji në shume prej €37.1milion, si dhe bilanci i depozitimeve të energjisë në KESH në fund vit është 4,643 MWh.

Sfidë kryesore e KEK-ut, për vitin 2020 ka qenë përqendrimi në realizimin e planit të prodhimit të energjisë dhe në vazhdimin e investimeve për ngritjen e kapaciteteve të prodhimit duke rritur disponueshmerinë e pajisjeve që do të zvogëlojnë kostot e operimit. Po ashtu, KEK-u vazhdon të investojë në zvogëlimin e ndotjes së ambientit për shkak të vjetërsisë së Blloqeve të TCA-ve, stafit të shtyrë në moshë dhe zëvendësimin e tyre me kuadro të reja, investimin në kultivimin e sipërfaqeve të mbuluara me djerrinë me depozitë të mbyllura dhe pyllëzimi i tyre për ta kthyer tokën në gjendje të mëparshme, të cilat investime do të vazhdojnë edhe gjatë viteve në vazhdim.

Në lidhje me projektin e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re, edhe gjatë vitit 2020 KEK ka ofruar dokumentacione dhe shënime tjera Aksionarit përmes Ministrisë së Ekonomisë, me të cilën është në koordinim për aktivitetet e mëtejme lidhur me këtë rast. Kontrata me kompaninë e përzgjedhur nga aksionari është nënshkruar me dt. 20 dhjetor 2017. Në kuadër të marrëveshjet për TCKR kanë qenë tri

marrëveshje që kanë prekur operimet e KEK (i) marrëveshja për furnizim me Linjit, (ii) Marrëveshja për deponim të hirit dhe grupe dhe (iii) marrëveshja për transfer të lokacioni. Aktualisht ky proces është në vonese për shkak të tërheqjes së kompanisë të përzgjedhur për ndërtimit e kapacitetit të ri.

Pavarësisht ecurisë së këtij projekti, për tu përkujdesur për mirëqenien dhe të ardhmen ndërmarrjes, KEK duhet të investoj në Divizionin e Mihjeve siç është përcaktuar në planin e detajuar investiv për hapjen e Minierës së re (Raporti i MIBRAG-ut).

Përveç aktiviteteve të veta të rregullta operative dhe financiare, gjatë vitit 2020 KEK ka pasur edhe një komunikim të intensiv me publikun.

- Me të gjitha mediat janë mbajtur kontaktet e vazhdueshme, janë dërguar të gjitha përgjigjet në pyetjet e parashtruara si dhe ishin lëshuar rregullisht njoftime për publik për aktivitetet kryesore të korporatës. Gjatë vitit 2020, kanë qenë rreth 900 përgjigje në pyetje, prononcime mediatike si dhe paraqitje publike.
- Gjatë vitit të kaluar, fokus mediatik vazhdoi të ishte ballafaqimi i KEK-ut me situatën e pandemisë, me theks të veçantë tek paraqitja e rasteve Covid pozitive në KEK. Është transmetuar mesazhi se përkundër faktit se KEK është duke punuar me kapacitet të plotë, sfidave të kufizimit të lëvizjes dhe reduktimit të stafit, janë zbatuar me sukses të gjitha masat mbrojtëse sipas rekomandimeve të IKSHP dhe vendimeve të ndërlidhura të Qeverisë. Gjithashtu, në të gjitha mediat janë reflektuar deklaratimet rreth menaxhimit të mirë të situatës në KEK për sa i përket gjurmimit dhe izolimit të rasteve me Covid. Ndërlidhur me këtë, gjatë muajve të parë të paraqitjes së pandemisë, teme mediale ishte edhe furnizimi i KEK-ut me pajisje mbrojtëse (maska dhe dezinfektues).
- Teme mediatike gjatë kësaj periudhe ishte çështja e mungesës së punëtorëve me fokus në efektet nga pandemia. Gjatë shtjellimit të kësaj teme nga ana mediave, u bë u qartë fakti se përkundër vështirësive për shkak të pandemisë dhe moshës së shtyre të punëtorëve, prodhimi dhe operimet në KEK nuk kishin asnjë ndërprerje apo ngecje nga plani. Në këtë rast u qartësua dhe u transmetua fakti se KEK është duke prodhuar në përputhje të plote me planin ( si dhe duke tejkaluar atë) ndërsa, mungesat në furnizim të konsumatorëve kishte të bënte me subjekte tjera nga KEK-u.
- Teme mediale me fokus të lartë gjatë viti 2020 ishte finalizimi i Planit të Veprimit të Zhvendosjes (PVZH) si dhe aprovimi tij nga ana e Ministrisë, për pjesën përfundimtareve (prej 129 ha) të Mihjes Sibovc Jug-Perëndim. Gjatë raportimit medial të kësaj, teme fokusi ishte rëndësia e kësaj zone për prodhim stabil të qymyrit dhe energjisë si dhe tek bashkëpunim i shkëlqyeshëm në mes të gjitha palëve ( KEK-ut, Ministrisë, Komunës dhe banoreve) në këtë proces jo të lehtë.

- Gjate disa muajve të vitit 2020 jehonë mediale kishin deklarimet publike nga Bordi rreth situatës që kishte gjetur në KEK për sa i përket operimeve, mungesës së stafit si dhe detyrimeve ligjore për shkak të padive. Ne këtë rast, u potencua fakti rreth zotimit të Bordit për një rishikim të integruar funksional të skemave dhe operimeve të KEK-ut.

### ***Burimet Njerëzore***

Si një vit me rrezik për shëndetin e njerëzve, viti 2020 kishte pikërisht vështirësitë e veta në menaxhimin e burimeve njerëzore. KEK ka filluar vitin me 4033 punëtorë për ta mbyllur me 3884. Edhe gjatë vitit 2020 kishte lëvizje të punësuarve, ku me konkurset e shpallura u punësuan, 153 punonjës të ri, ndërsa ndërprerjet e marrëdhënies së punës ishin më të mëdha. Gjate vitit janë pensionuar 229 punonjës ndërsa 28 kanë ndërruar jetë (para moshës 65 vjeçare) nga shkaqe të ndryshme natyrore përfshirë edhe Covid-19. 27 punonjës të tjerë kanë ndërprerë marrëdhënien e punës për arsye të ndryshme, nga ta 12 punëmarrës me marrëveshje (SMO) kane shkëputur kontratën e punës.

- Gjate muajit tetor kishin filluar procedurat e përzgjedhjes rreth konkursit publike të shpallur me 14.09.2020. Në këtë rast, pas filtrimit fillestar, kishin përfunduar testimet me shkrim të mbi 8000 kandidatëve që kishin aplikuar për 171 pozita të shpallura. Për momentin të gjitha procedurat rreth kësaj shpallje, sipas rekomandimit të Bordit, janë pezulluar deri në njoftimin e radhës.
- Gjatë kësaj periudhe 12 mujore gjithashtu janë dhënë 12 vërejtje dhe vërejtje të fundit me shkrim, 9 suspendime të përkohshme, dhe kemi pas 2 shkëputje të kontratës së punës për shkak të shkeljeve të detyrave të punës.

Aktivitetet e trajnimeve gjate vitit 2020 ishin të limituara kryesisht për shkak të kufizimeve lidhur me masat për parandalimin e përhapjes së virusit. Megjithatë, gjatë vitit 2020 janë organizuar trajnime në masë të konsiderueshme, ku 914 sa ishte planifikuar, numri i të trajnuarve ishte 328 persona nga të cilët 95 ishin nga jashtë KEK sipas shpalljeve publike për organizimin e trajnimeve profesionale nga qendra trajnuese e KEK. Numri i ditëve të trajnimeve ishte 1,196 ditë trajnime për modulet: teknologji mekanike, teknologji e saldimit, teknologji elektrike, siguria në punë dhe menaxhim dhe administrim.



## Departamenti i Mjedisit

- Janë përgatitur dhe dërguar rregullisht raportet periodike mujore për gjatë tërë vitit 2020, në MMPH dhe Komune të Obilicës, si dhe është përgatitur dhe është publikuar raporti vjetor i gjendjes mjedisore në KEK për vitin 2019, ku janë përfshirë të dhënat bazë që rezultojnë nga monitorimi i mjedisit, si dhe janë paraqitur çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në KEK. Me këtë rast, aty janë paraqitur shënimet monitoruese integrale të tërë sistemit, duke filluar nga lënda e parë, prodhimi dhe shfrytëzimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike dhe efektet në mjedis.
- Është përgatitë dhe dorëzuar në Gjykatë, ankesa ndaj gjobës së lëshuar nga Inspektorati Mjedisit (të Ministrisë) për ndotje të pretenduar të ujërave të lumit Llap nga TCB.
- Edhe pse me një dinamike më të vogël për shkak të pandemisë, gjatë këtij viti kanë vazhduar disa aktivitete në terren dhe inspektimet e rregullta që kanë të bëjnë me çështje mjedisore në njësi prodhuese brenda KEK-ut; si dhe
- Gjatë tërë vitit ka vazhduar komunikimi dhe koordinimi rregullt me institucionet relevante shtetërore për mbrojtje të mjedisit.

## Siguria Fizike

Siguria fizike e objekteve dhe hapësirës së KEK-ut që nga prilli i vitit 2004 sigurohet nga kompanitë private të licencuara për këtë lëmi. Hapësira dhe objektet që sigurohen janë në një sipërfaqe prej më shumë se 4,500 hektar. Në këtë hapësirë përfshihet Mijha sipërfaqësore, me të gjitha objektet dhe infrastrukturën tjetër (shiritat transportues, mekanizimi ndihmës, sistemi shiritave, rrejtë elektrik dhe ekskavatorët), Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, si dhe hapësira të mëdha të objekteve që nuk janë tashmë në funksion. Bashkëpunimi me operatorin ka vazhduar edhe gjatë 2020 si dhe ka pas raste bashkëpunimi të mirë me Policinë e Kosovës, ku vetëm në tre muajt e fundit (tetor-dhjetor) ka pasur 52 thirrje për Policinë për asistim nga ana e rojeve dhe në këto thirrje Policia e Kosovës është përgjigjur pozitivisht në 50 sosh. Ky bashkëpunim ka rezultuar edhe në identifikimin dhe kapjen e hajnave nga ana e Policisë. Në bazë të këtyre bashkëpunimeve ka pasur edhe arrestime dhe dërgim në paraburgim.

## **Performanca Operative dhe Indikatorët kyç të Performancës**

### **Indikatorët kyç të Performancës për vitin 2020**

Viti 2020 ka qenë një vit i mirë është një nga vitet më të mira për sa i përket prodhimit dhe mbulimit të kërkesave për energji elektrike. Indikatorët Kyç të Performancës tregojnë se divizionet kanë shënuar progres, duke realizuar panin e prodhimit të qymyrit dhe të prodhimit të energjisë. Në raport me vitin paraprak, prodhimi i energjisë ishte më i lartë për 11%.

Indikatorët Kyç të Performancës të cilët janë raportuar nga divizionet shërbyese brenda korporatës siç janë: financat, zyra ligjore, burimet njerëzore dhe shërbimet e korporatës, ofrojnë të dhëna në bazë të aktiviteteve për raportim në baza periodike. Informatat janë të rëndësishme për ecurinë e gjendjes financiare apo raportimin e gjendjes së të punësuarve që i shërbejnë Menaxhmentit dhe Bordit lidhur me marrjen e vendimeve të tanishme dhe vendime strategjike për të ardhmen e Korporatës.

### **Divizioni i Mihjeve**

Roli i Divizionit të prodhimit të qymyrit është furnizimi në kontinuitet i Termocentraleve me qymyr në sasi dhe cilësi në bazë të kapaciteteve të pajisjeve ekzistuese, duke synuar kosto sa më të ulët të operimit dhe në ngritje të produktivitetit të prodhimit, në respektimin e bazës ligjore dhe rregulloreve në fuqi për sigurinë e minierës, personelit dhe pajisjeve të DPQ-it.

Dy Indikatorët kyç të performancës së DPQ-it janë zhvendosja e djerrinës si dhe prodhimi i qymyrit të cilët janë treguesit kryesor matës dhe monitorues të krahasimit mes planit dhe realizimit të Planit Energjetik të aprovuar për vitin 2020 .

Për prodhimin e Qymyrit, matja e performancës bëhet me kapacitetin dhe gjendjes e pajisjeve nga 18,000-36,000 ton ditor.

Për IKP-së, të zhvendosjes së Djerrinës, treguesi matës për këtë IKP-së, bëhet në bazë të kapacitetit dhe gjendjes së pajisjeve nga (25,000-50,000) ton ditor të prodhimit të djerrinë me të cilën vijmë deri tek mesatarja vjetore për zhvendosjen e djerrinës në ditë.


Rol më rëndësor për DPQ-it ,është mbajta e nivelit të rezervave të thëngjillit brenda kufirit, për TCA- 80,000-250,000 ton ,ndërsa për TCB-130,000-360,000 ton rezerva në depo.

Divizioni i Mihjeve kishte për objektiv, si pjesë e Planit të Biznesit 2020, prodhimin e 8.55 milionë ton thëngjill dhe 13.0 milionë m<sup>3</sup> djerrinë. Për implementimin e këtij plani në shërbim ishin lokacionet si Sibovci Jug- Perëndimor. Secila nga këto departamente kishte planet operative vjetore.

Siç shihet në Tabelën 1, prodhimi i Thëngjillit për vitin 2020 ka qene 8,537,948 ton apo 0.02% me e ultë se sa ishte planifikuar. Kurse, në segmentin e Djerrinës janë prodhuar 11,621,493 m<sup>3</sup> apo 11.60% është më pak se plani vjetor i 2020.

Indikatori Kyç i Performancës	Njësia	2019		% e Realiz.	2020		% e Realiz.
		Plani	Realizimi		Plani	Realizimi	
<b>Sibovci Jug-Perëndimor</b>							
<b><u>Prodhimi i Qymyrit</u></b>	ton	7,970,000	8,063,051	101.17	8,552,170	8,537,948	99.83
<b><u>Prodhimi i Djerrinës</u></b>	m <sup>3</sup>	12,250,000	11,139,541	89.12	13,000,000	11,621,493	89.40

**Tabela 1 - Plani dhe Realizimi Divizioni i Mihjeve 2019-2020**



Në tabelën e lart paraqitur (Tabela 1) vërehen disa shmanjie në realizim. Ky realizim dhe përafrim i planit të prodhimit të Qymyrit në raport me atë të parashikuar, është për shkak të ngritjes së efikasitetit dhe produktivitetit në punë dhe investimeve të vazhdueshme në pajisje dhe kapacitete prodhuese.

Prodhimi i Djerrinës (nga Tabela 1) në total kishte realizueshmëri prej 89.40%, dhe qëllimi i Divizionit të Mihjeve ishte që të zhvendoset sa më shumë djerrinë nga Sibovci Jug-Perëndimor dhe të zbulohen rezerva të mjaftueshme në atë pjesë, mirëpo mos arritja e planit të paraparë është për shkak të pengesave nga vitet e kaluara në zhvendosjen e banorëve të fshatit Shipitullë, si dhe sanimi i shpatit perëndimor në S.J-P, ndërsa prodhimi i qymyrit ishte në vije me planin dhe e mjaftueshme për kërkesat e njësive gjeneruese.

Investimet kapitale këto dy vitet e fundit që kapin shifrën e më shumë se €35.44 milionë kanë pasur efekt konstruktiv në efikasitetin e Divizionit të Mihjeve. Realizimi i shpronësimeve gjatë vitit 2020 kishte një ecuri të mirë me € 13.17 milion të realizuar çka e ulë ndjeshëm rrezikun për pengesa në prodhim dhe në zhvillimin e mëtejshëm të planit ekzistues xehetar për avancimin e minierës ekzistuese. Pas shterimit të rezervave në sektorin e Sitnicës është mbyllur ky sektor dhe trajtimi ambiental të këtij sektori është bërë sipas planit duke hedhur mbetjet e hirit nga Termocentralet.


## Divizioni i Gjenerimit

Divizioni i Gjenerimit për vitin 2020 ka arritur rezultate të mira. Tek indikator i Disponueshmërisë shihet se blloqet e kanë arritur përafërsisht planin dhe Performanca efektive e blloqeve si tërësi ka mundësuar të përmbushet plani i prodhimit bruto dhe neto.

	Njësia	Viti 2019		(%) e realiz.	Viti 2020		(%) e realiz.
		Plani	Realizimi		Plani	Realizimi	
Disponueshmëria kohore							
<u>A3</u>	%	53.25	56.48	1.06	58.56	61.75	1.05
<u>A4</u>	%	55.27	96.31	1.74	51.64	81.98	1.59
<u>A5</u>	%	52.50	86.48	1.65	58.61	63.35	1.08
<u>B1</u>	%	87.99	87.06	0.99	90.50	94.81	1.05
<u>B2</u>	%	87.21	89.72	1.03	82.35	87.49	1.06
Gjenerimi Bruto							
<u>Kosova A</u>	MW/h	2,111,014	2,366,471	1.12	2,134,197	2,395,776	1.12
<u>Kosova B</u>	MW/h	3,711,212	3,670,103	0.99	4,071,736	4,267,190	1.05
TOTALI (Kosova A + B)	MW/h	5,822,226	6,036,574	1.04	6,205,934	6,662,965	1.07
Gjenerimi Neto							
<u>Kosova A</u>	MW/h	1,857,601	2,072,285	1.12	1,878,000	2,113,892	1.13
<u>Kosova B</u>	MW/h	3,354,635	3,325,467	0.99	3,641,132	3,869,299	1.05
TOTALI (Kosova A + B)	MW/h	5,212,236	5,403,752	1.04	5,558,832	5,983,192	1.08

**Tabela 2 - Divizioni TCA dhe TCB 2019-2020**

Siç shihet në tabelën 2, gjenerimi bruto dhe neto kanë arritur të përmbushin planin e prodhimit në shkallë 1.07 % (bruto) apo më tepër për 7 % me atë të planifikuar, respektivisht 1.08% (neto) apo më tepër për 8 % me atë të planifikuar.





Krahasuar me vitin 2019, viti 2020 (shiko Tabelën më lart) ka më shumë prodhimtari bruto dhe neto, diku përreth 11.0 % më shumë se prodhim të energjisë elektrike në raport me vitin paraprak. Sipas Diagramës

shihet se KEK ka shënuar rekord historik të prodhimit më i larti ndonjëherë që nga viti 1962. Kjo pasqyron faktin se investimet e vazhdueshme kapitale kanë luajtur rol kyç në rritjen e efikasitetit të divizionit. investimet kapitale në Divizionin e Gjenerimit që për vitin 2020 ishin €12.2 milionë.

## Performanca Financiare

Megjithëse vit i ndikuar nga pandemia, performanca e përgjithshme e KEK-ut për vitin 2020 shfaqet më së miri përmes rezultateve financiare. Tashmë KEK ka vazhduar rezultatet e mira financiare. Viti 2020 rezultoi me një ngritje të fitimit neto për 23.73% krahasuar me vitin 2019. Ky fitim ishte kryesisht si rezultat i rritjes së shitjeve të energjisë elektrike. KEK ka pasur rritje të ndjeshme edhe në kapitalin e vet punues si rezultat i ndryshimit të planeve investive nga shtyrja e projekteve të ndërlidhura me investimet e BE si dhe për shkak të pandemisë. Megjithatë kualiteti i fitimeve vazhdon të jetë i lartë.

Raportet e performacës	2020	2019	2018	2017
Qarkullimi i aseteve	0.46	0.44	0.39	0.41
Margjina e fitimit neto	12.32	10.38	10.32	11.76





EBITDA shpesh i referohemi si një indikator i performacës financiare i cili mat fitimin me bazë të parase së gatshme nga operacionet e vazhdueshme. Ajo është edhe një tregues i mirë i aftësisë së korporatës për të investuar në zëvendësimin e aseteve dhe në zgjerim biznesi. Gjatë vitit 2020 është përlllogaritur € 67.44 milion krahasuar me € 60.11 milion sa ishte në 2019.

Në vijim, edhe efikasiteti i përdorimit të aseteve është rritur gjatë vitit 2020. Përkundër faktit se një numër i konsiderueshëm i punëtorëve nuk ka qenë në punë gjatë vitit si rrjedhojë e masave parandaluese për



përhapjen e pandemisë, KEK ka rritur aftësinë e gjenerimit të hyrave nga viti në vit duke rritur qarkullimin mesatare asetëve nga viti 0.44 sa ishte në 2019 në 0.46 në vitin 2020. Po ashtu marxhina e fitimit neto është rritur në 12.32 % nga 10.38% sa ishte në vitin 2019. Kjo kryesisht si rezultat i gjenerimit të më shumë



flukseve hyrëse të parasë me përdorimin e të njëjtave burimeve, si dhe me të njëjtat operacione në dispozicion. Megjithatë rezultatet e përfshira në analizë injorojnë faktorët rastësor ose të shpenzimeve jo të vazhdueshme të cilat për shkak të natyrës së biznesit, moshës së punonjësve, vjetërsisë së asetëve apo ndryshimeve të herë pas herëshme në rregulloret e ZRRE për tarifatat krijojnë ngarkesa financiare që zvogëlojnë fitimin e periudhës.

## Pasqyra e të ardhurave

Siç shihet në draft pasqyrat financiare, korporata ka regjistruar një rezultat neto pozitiv për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 në shumë prej €23,78 milionë. Fitimi i realizuar për vitin i atribuohet kryesisht rritjes së të hyrave nga shitja e energjisë ku me shpenzime përafërsisht të njëjta me vitin paraprak, rritja e të hyrave ka ndikuar në rritjen e fitimit neto.

Grantet e prezantuara në PA për 2020 janë grante të shtyra në vlerë € 5.22 milion. Kompania për vitin 2020 nuk ka marrë grante nga Qeveria apo forma të tjera.

Të hyrat operative totale të realizuara për vitin 2020 janë në shumë prej €193,02 milionë dhe janë me të larta për €7.89 milionë krahasuar me vitin 2019 ose shprehur në përqindje 4.2 % më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje e të hyrave i atribuohet kryesisht shitjes së energjisë elektrike.

Duke analizuar më në detaje, të hyrat nga veprimtaria janë këto:


	31 Dhjetor 2020 (in EUR 000)	31 Dhjetor 2019 (in EUR 000)	ndryshimi në %
<b>Shitja e energjisë</b>			
Të hyra nga shitja e energjisë	141,001	135,867	4
Të hyra nga jo-balanca	3,836	3,318	16
Të hyrat nga ko gjenerimi	1,286	1,131	14
Eksporti i Energjisë *	37,071	32,544	14
	<b>183,194</b>	<b>172,860</b>	<b>6</b>
<b>Shitjet tjera</b>			
Shitja e thëngjillit	1,994	3,230	(38)
tjera	656	772	(15)
	<b>2,650</b>	<b>4,002</b>	<b>(34)</b>
<b>Gjithsej të hyra nga veprimtaria</b>	<b>185,844</b>	<b>176,862</b>	<b>5</b>

\*Tek eksporti i energjisë përfshihet edhe shkëmbimi i energjisë me KESH SHA. KEK ka filluar eksportin e energjisë më 31 maj 2019. Para kësaj date eksporti është realizuar nga KESCO për llogari të KEK.

- Të hyrat nga veprimtaria për këtë vit janë realizuar në shumë prej € 185,84 milionë kundrejt €176.86 milionë një vit më parë me një rritje prej 5.1% ose € 8,98 milionë më shumë. Megjithëse kemi pas një rritje të të hyrave, ndikim në shkallën e rritjes (*përkundër rritjes së sasisë së energjisë së shitur për 11.8 % krahasuar me vitin paraprak 2020: 5.78 GWh me 2019: 5.17 GWh energji elektrike neto*) kanë pasur edhe çmimi për energjinë e eksportuar, i cili si mesatare e vitit 2020 ishte më i ulët krahasuar me vitin 2019 për 8.9 €/MWh.
- Po ashtu, efekt kishte edhe rritja e kërkesës së energjisë për USS në raport me energjinë për mbulimin e humbjeve. Përkundër nevojës së KEK për reflektimin e kostove të shpenzimeve dhe nevojave për investime për të ardhmen, çmimet e energjisë për furnizim me shumicë për shërbim universal (USS) si dhe ato për mbulimin e humbjeve u mbajtën të pandryshuara: 29.5€/MWh dhe 36€/MWh respektivisht, për të mos ndikuar në çmimet e konsumatorëve fundor në kohën kur vendi po ballafaqohet me probleme ekonomike si rrjedhojë e pandemisë.
- Të hyrat nga grantet janë realizuar këtë vit në shumë prej € 5,22 milionë kundrejt një viti me parë me një ulje prej 10% ose € 0.6 milionë sipas shkallës së zhvlerësimit të aseteve me të cilat janë të lidhura grantet e dhëna nga viti 2010, viti i fundit kur KEK ka përfituar grantet nga qeveria.
- Të hyrat tjera janë realizuar këtë vit në shumë prej € 1,96 milionë kundrejt një viti me parë me një uljeje prej 19.2% ose me të ultë prej € 0.466 milionë. Shitja e thëngjillit me kontratën ekzistuese me Kosova Thëngjillin nuk është realizuar sipas planifikimeve për shkak të humbjes së një pjese të tregut nga ana blerësit të KEK kryesisht për shkak të pandemisë.

## Faktorë tjerë që ndikojnë në të hyrat

KEK ka marrëveshje për shitjen me shumicë të energjisë tek KESCO dhe KEDS të cilat rregullojnë detyrimet e palëve. Këto marrëveshje obligojnë KEK për nominimin e sasisë së prodhuar tek këta dy Operator dhe pjesën e mbetur nga energjia e eksporton. Si rrjedhojë e këtyre raporteve me blerësit kryesorë, e ndikuar nga presioni i mbajtjes së balancës sociale në vend ku synohet ofrimi i energjisë me kosto sa më të ulët, KEK nuk ka fleksibilitet në negocimin e çmimeve të energjisë. Si rrjedhojë edhe e pandemisë COVID -19, KEK ka marr vendim në BtD për mbajtjen e çmimeve të pandryshuara me të vetmin qëllim që të mos reflektohet në rritjen e koston të jetesës për konsumatorët fundor. Nevoja për rritjen e çmimit të energjisë vjen si rezultat i obligimeve që KEK ka karshi strategjisë së Qeverisë së Kosovës dhe objektivave të veta për stabilitetin e prodhimit të energjisë, e cila mund të garantohet vetëm me realizimin e investimeve të domosdoshme. Figurat më poshtë japin një pasqyrë të aftësisë negociuese në përcaktimin e çmimit nën kushtet e numrit të vogël të blerësve dhe specifikave të korporatës në shitjen e energjisë si dhe rrjedhimisht ndikimi në realizimin e të hyrave:




Pamundësia e arritjes së marrëveshjeve individuale për shitjen e energjisë për blerësit deri në 35kV (kryesisht për shkak të kufizimeve të cilat ekzistojnë në Marrëveshjet për Furnizim me Shumicë), dhe pamundësia e operatorëve për tu përgatitur për liberalizimin e tregut të energjisë është një sfidë për të ardhmen dhe e cila mund të ketë ndikim pozitiv në të hyrat e korporatës.

## Pasqyra e shpenzimeve

Gjithsej, shpenzimet operative për vitin 2020 janë realizuar në shumë prej €162.55 milionë e që krahasuar me € 160.27 milionë të vitit paraprak, janë më të larta për €2.3 milion. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kishin shpenzimet e tantumës të lidhura me prodhimin e thëngjillit si dhe shpenzimet për materialet e mirëmbajtje të cilat po ashtu janë të lidhura me pamundësinë e realizimit të investimeve kapitale sipas planit për shkak të pandemisë.

Më poshtë, paraqitet në mënyrë grafike struktura e shpenzimeve sipas pjesëmarrjes si dhe krahasuar me vitin paraprak:



- Shpenzimet e zhvlërsimit janë më të larta se viti paraprak me € 3.85 milion. Këtu kanë ndikuar ndryshimet në vlerësimet kontabël si rrjedhojë e rivlerësimi të jetës së mbetur të dobishme të aseteve i cili ka rezultuar me ndryshim në shumën e amortizimit të aseteve. Gjatë vitit 2020 KEK ka formuar komisionet profesionale për vlerësimin e jetës së dobishme të mbetur të aseteve. Si rezultat i këtij aktiviteti ka rezultuar me ndryshime në vlerësimet kontabël për zërin e zhvlërsimit dhe e njëjta ka reflektuar në pasqyrën e të ardhurave për 2020.
- Shpenzimet e personelit, arrin në € 54.17 milionë në vitin 2020, nga € 56.33 milionë të vitit 2019, pra janë më të vogla për rreth €2.16 milionë. Në Shpenzimet e personelit për vitin 2020, janë përfshirë edhe pagesa për punëtorë për rrezikun e pandemisë sipas vendimeve të BtD, tre muaj (Mars, Prill dhe Dhjetor) nga 300 € për punëtorë, që në total për vitin 2020 kapin shumën e € 3 milion.
- Shpenzimet e energjisë ku përfshihet importi dhe lëndët djegëse në vitin 2020 arritën në € 16.63 milionë dhe janë më të ulëta krahasuar me vitin paraprak për €1.29 milionë. Zërat kryesor në këto shpenzime ishin shpenzimet e transimit me 7.4 milion që reflektojnë ndryshimin e vendimit

ZRRE për shkallën e tarifës për çasje në rrjet të transmisionit të KOSTT.

<b>SHPENZIMET E ENERGJISË (në EUR' 000)</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Derivatet	4,840	5,632
Transmisioni	7,404	8,186
Shpenzime për mbulimin e humbjeve (Vendimi 909_2017 i ZRRE)	3,052	2,744
Uji dhe Gazi	718	826
Shkëmbimi i energjisë	616	535
Të tjera	-	-
	<b>16,630</b>	<b>17,923</b>

- Shpenzimet tjera operative në tabelën e mëposhtme, janë realizuar në shumë prej €11.41 milionë apo rreth €1.74 milionë me të ulëta se në vitin paraprak. Në këto shpenzime përfshihen edhe shpenzime jo të vijueshme si shpenzimet për burimet minerale, shlyerja e parapagimeve tatimore.

<b>SHPENZIME TË TJERA (në EUR' 000)</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Shpenzime për burime minerale	2,371	-
Shpenzime të sigurimit	1,713	1,828
Rastet gjyqësorë	2,518	1,683
Licenca	1,183	1,216
Shpenzime jo të prodhimit	600	811
Shpenzime për mbledhjen e borxheve të vjetra –(KESCO)	86	261
Shlyerja të PPE dhe Stoqeve	392	401
Komunali	252	294
Shpenzimet e taksave	190	185
Shpenzime e çështjeve gjyqësore dhe konsulencë	235	147
Shërbime transportit	52	94
Dogana	94	-
Dënime tatimore	-	5,874
Shlyerja e të arkëtueshmeve dhe aseteve tjera	835	214
Të tjera	889	143
	<b>11,410</b>	<b>13,151</b>

Si përfundim, në përgjithësi shpenzimet operative kryesisht kanë pozitë të krahasueshme me vitin paraprak sa i përket shpenzimeve të vijueshme. Ndërsa ka pas rritje të shpenzimeve jo të vijueshme, si rasti i shpenzimeve minerare, e korrigjimeve në pasqyra apo shlyerja të aseteve (parapagimeve për tatimet 2011) apo edhe shpenzimeve zhvlerësimit të cilat kanë ndodhur si rrjedhojë e vlerësimit të jetës së dobishme të mbetur të aseteve etj. Rritja e shpenzimeve ka pas edhe për kategoritë e shpenzimeve që lidhen me procesin e prodhimit, dhe që kanë një korrelacion të drejt me trendin e prodhimit si rasti i tantimës; ose rritja shpenzimet e derivateve të cilat janë në lidhje me numrin e ndalesave të paplanifikuara



## Gjendja e Kompanisë

Kompania vazhdon të jetë në gjendje të mirë dhe me aktivitetin e vet ka rritur vlerën e aksionarit në kompani. Vlera e aseteve është rritur në vitin 2020 në €425.21 milion krahasuar me 417.04 në 2019.

Paraja e gatshme në llogari është rritur si rezultat i performancës së mirë gjatë vitit, përkundër rrjedhjeve të paplanifikuara të parasë së gatshme gjatë vitit 2020. Ndërsa, zvogëlimi i stokeve ka ndodhur si rezultat i rritjes së sasisë së stokeve të futura në përdorim, kryesisht gjatë remontit të rregullt të realizuar në TCA dhe TCB, por edhe për aktivitete të mirëmbajtjes.

Tek ndryshimi i vlerës së aseteve, rritja më e ndjeshme u shkaktua nga rritja e llogarive të arkëtueshme dhe parapagimet ndaj furnitorëve të cilat shkaktar kryesor kanë gjendjen e pandemisë.

KEDS dhe KESCO gjatë vitit 2020 kanë deklaruar vështirësi në inkasimin e mjeteve nga konsumatorët e tyre, duke u vonuar në pagesën e faturave sipas marrëveshjes. Marrëveshja parasheh aplikimin kamatave ndëshkuese për rastet e vonesave në pagesë dhe si të tilla e ka rritur vlerën e llogarive të arkëtueshme.

Po ashtu parapagimet ndaj kontraktorëve të KEK të cilët janë pamundësuar të vijnë punën për shkak të ndryshimeve në Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike (BVEE), pe ndërlidhur me shtyrjes për vitet në vijim (2022/2023) të projekteve të BE për Elektrofiltra dhe DeNx.

Llogaritë e Arkëtueshme tregtare neto janë €40.85 milion krahasuar me €22.61 milion në vitin 2019.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare në euro' 000	2020	2019
<b>Të arkëtueshmet tregtare:</b>		
Konsumator vendor	42,763	30,049
Konsumatorë të jashtëm	4,510	4,927
Interesi akrual	883	
	<b>48,156</b>	<b>34,976</b>
Lejimet (shënimi 27.B në PF)	(13,873)	(16,706)
	<b>34,283</b>	<b>18,270</b>
<b>Të arkëtueshme tjera dhe parapagime:</b>		
Parapagime furnitorëve	5,616	4,361
TVSH e arkëtueshme	-	372
Garancione bankare	10	316
Të arkëtueshme të tjera	1,584	991
	<b>7,210</b>	<b>6,040</b>
Lejimet për humbjet nga të arkëtueshmet dhe parapagimet (shënimi 27.B në PF)	(643)	(1,696)
<b>Total të arkëtueshme tjera</b>	<b>6,567</b>	<b>4,344</b>
<b>Total</b>	<b>40,850</b>	<b>22,614</b>

Detyrimet janë zvogëluar krahasuar me vitin paraprak për vlerën e detyrimeve të shlyera për pjesën e kredisë dhe për detyrimet rrjedhëse për furnitorët të shlyera gjatë periudhës

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë zvogëluar për €1.5 milion respektivisht nga € 15.26 milion sa ishin në 2019 në € 13.79 milion në vitin 2020.

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera (Në €' 000)	2020	2019
<b>Furnitorët:</b>		
Vendor	6,991	8,321
Të jashtëm	2,174	2,512
<b>Total furnitorët</b>	<b>9,165</b>	<b>10,833</b>
Të tjera (pagat, tatimet dhe kontributet pensionale, etj)	4,634	4,426
<b>Total Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera</b>	<b>13,799</b>	<b>15,259</b>

## Progresi i Projekteve Kapitale

Investimet kapitale nuk kane pas një realizim sipas planit përfshirë edhe disa nga faktorët e përmendur në këtë raport të ndërlidhur me Covid-19. Dinamika e punës rreth kompletimit të projekteve mund të mos përfundojë brenda vitit dhe të vazhdojë në vitin vijues. Në fakt, disa projekte pritet të përfundojnë gjatë vitit 2021 dhe 2022 si projekte afat-mesme të kontraktuara nga ana e KEK-ut me operatorët ekonomik.

## Shpenzimet kapitale dhe projektet

Projektet kanë vazhduar me dinamikë racionale. Investimet kapitale për vitin 2020 kanë shënuar rritje prej €2.46 milionë në krahasim me vitin paraprak. Te gjitha investimet në këtë periudhe janë realizuar nga mjetet vetanake të KEK-ut, dhe nuk ka pasur financim nga huat. Shpenzimet për investime kapitale të financuara nga KEK-u sipas divizioneve për periudhën raportuese janë realizuar në shumë prej € 36.91 milionë .

Investimet kapitale në '000€	2020	2019
Mihje	24,072	13,250
Gjenerimi	12,200	20,836
Te tjera	637	401
<b>Totali</b>	<b>36,910</b>	<b>34,453</b>

## Divizioni i Mihjeve

Shuma e shpenzimeve kapitale për divizionin e mihjeve për vitin 2020 arrin në €24.07 milionë.

Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion është si vijon:

- Përvetësimi i tokave, €13.17 milionë.
- Shpime Hulumtuese fusha e Jugut , €2.80 milionë.
- Riparimi kapital elektromekanik i Ekskavatorit E9B SRs-1300, €2.23 milionë.
- Riparimi elektromekanik i një shirit vetëlëvizës BRs 1200, €0.94 milionë.
- Riparimi elektromekanik i Ekskavatorit E4M SRs-470, €0.32 milionë.
- Ekskavator hidraulik me vemëza , €0.27 milionë.
- Riparimi i shiritave Magjstral te qymyrit drejtimi TCB (TMLa1, b1, a2, b2, 9a, 9b, 4a, 4b, 14a dhe 14b) ,€ 0.14 milionë.
- Ekskavator hidraulik teleskopik me rrota (2 copa) , € 0.48 milionë.
- Automjete Tereni 4 cope, € 0.13 milionë.
- Detektor për metale dhe Seperator elektromagnetik, € 0.28 milionë.
- Vendosja e murit mbrojtës përgjatë rrugës së asfaltuar Separacioni ,A''(projekt I ndaljes së zhurmës dhe mbrojtjes së banoreve nga pluhuri), € 0.19 milionë.
- Gypa plastik Ø 300 ,L=3000M , € 0.13 milionë.
- Riparim kapital u urës së pjerrtë B=1600), € 0.27 milionë.
- Rrethimi i punëtorisë në Bardh, € 0.10 milionë.
- Remontimi i stacionit veprues B=1800 mm, €2.56 milionë.
- Projektet tjera të realizuara dhe realizimi të cilat priten gjatë vitit 2021, €0.15 milionë.

Dinamika e punës rreth përfundimit të disa projekteve mund të mos përfundojë brenda vitit dhe të vazhdojë në vitin vijues.

## Divizioni i Gjenerimit te Energjisë

Shuma e shpenzimeve kapitale për divizionin e gjenerimit (TC Kosova dhe TC Kosova B) për vitin 2020 arrinë në €12.2 milionë. Lista e shpenzimeve kryesore për këtë divizion është si vijon:

- Riparimi i sinjalizimit dhe mbrojtjes në bllokun A4, €0.14 milionë.
- Furnizim me elektromotor te mullinjve, trafoja T5A dhe elektromotor për pompa furnizuese Lot 2  
Furnizim me trafo T5A 15.75 6.3, €0.25 milionë
- Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompave furnizuese ekzistuese, €0.59 milionë
- Furnizim me elektromotor te mullinjve, trafoja T5A dhe elektromotor për pompa furnizuese Lot 2  
Furnizim me elektromotor te mullinjve, €0.18 milionë
- Liferimi dhe montimi i rampës te hidrogjenit CO2 në bllok. A3. , €0.38 milionë
- Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A3, €1.11 milionë
- Demontimi, liferimi dhe montimi i shpërndarësve 0.4 kV, €0.15 milionë
- Furnizimi me rotor te zgjueses, €0.10 milionë
- Projekte tjera të realizuara në TCA, €0.24 milionë
- Liferimi dhe ndërimi i gypave te avullit përcjellës te mazutit dhe armaturës dhe valvave, brylave,

prej stacionit të mazutit brenda blloqeve B1-B2 deri te brenerat, €0.18 milionë.

- Ndërrimi i rezervuarëve të acidit në PKU, €0.11 milionë.
- Furnizim me reduktor të skarës, €0.28 milionë.
- Rehabilitimi i sistemit të ngasjes së mullinjve në TC Kosova B, €0.90 milionë.
- Furnizim me valva për salle të makinave dhe PKU, €0.38 milionë.
- Blerja e dy rotorëve të Mullirit të tipit VENTILATORIK, €0.40 milionë.
- Liferimi, instalimi dhe komisionimi i teknologjisë “Smart” të fryrësve të blozës në zonën e vatrës së kaldajës B1 & B2, €1.71 milionë.
- Ndërrimi i këmbyesve të nxehtësisë si dhe ndërrimi i hojeve të nxehtësisë të ajrit në B1 dhe B2 në TC Kosova B, €2.86 milionë.
- Furnizim me Valvat për armaturën e kaldajës B1 & B2, €0.24 milionë.
- Prodhimi , instalimi dhe komisionimi i ashensorit elektrik industrial, €0.19 milionë.
- Riparimi i katër xhantave hidrodinamike VOITH të pompës furnizuese, €0.92 milionë.
- Liferimi dhe montim i ritejnxemsave RBT dhe RHT në TC “Kosova B” në njesin B2, €0.77 milionë.
- Ndërtimi i deponisë së re të hirit në fushën e Sitnices, €0.12 milionë.
- Prodhimi dhe liferimi i një reduktori të skarës, €0.18 milionë.
- Demontimi , blerja dhe montimi i zbarave të statorit si dhe komisionimi gjeneratorëve G1 dhe G2 në TC Kosova B, €0.97 milionë.
- Rehabilitimi i ndërtesës së mensës në TC Kosova B, €0.30 milionë.
- Përmirësimi i sistemit të kontrollit, pjesa HMI në PKU, €0.13 milionë.
- Riparimi i kades së neutralizimit në PKU-së në TCB, €0.10 milionë.
- Projektet tjera kapitale në TCB, €0.99 milionë.

Një pjesë e projekteve kapitale për Divizionin e Gjenerimit do të vazhdojnë edhe në vitin tjetër, sidomos ato në mbrojtjen e mjedisit dhe në kapacitetet gjeneruese.

## **Divizioni i Shërbimeve të Korporatës**

Shuma e shpenzimeve kapitale për divizionin e shërbimeve të korporatës (që përfshin sektorin e IT-së) për vitin 2020 arrin në €637 mijë, që përfshinë furnizime me pajisje elektronike.

## PLANI I BIZNESIT DHE PERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Plani i Biznesit 2021 identifikon synimet e korporatës, plotësimi i të cilave do t'ia mundësonte KEK-ut të arrijë objektivat strategjike, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e performancës financiare të kompanisë, duke rritur inkasimin e të ardhurave potenciale, përgatitjen e shthurjes funksionale (miniera e thëngjillit dhe gjenerimi), drejt qëllimit të afarizmit të qëndrueshëm, të cilat zotërohen, menaxhohen dhe operohen në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Synimet e korporatës janë zbërthyer në një numër objektivash dhe qëllimesh numerike, të cilat duhet t'i arrijnë KEK-u dhe divizionet e saj. Plani afarist do t'i mundësojë KEK-ut që të gjurmojë, monitorojë dhe vlerësojë performancën e tij në nivel qendror dhe të divizioneve, dhe të përgatisë plane të detajuara veprimi për implementimin e suksesshëm të strategjisë zhvillimore të Korporatës Energjetike të Kosovës për vitet 2021-2025 e cila përfshinë projektet kryesore kapitale:

### **a. Plani Zhvillimor dhe Investiv ne Minierat Sipërfaqësore**

Plani zhvillimor dhe investiv i minierës është përgatit duke shfrytëzuar dokumentin nga plani i detajuar i prodhimit dhe investimeve për Minierën e Re. Në këtë planë të punuar nga Konsorciumi Mibrag, janë paraparë riparimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve ekzistuese dhe aktualisht janë në proces të riparimit E4 M në platon qendrore, E9B në platon në shpatin lindor, S.V. B=1800mm dhe hartimi i specifikimit teknik për blerjen e ekskavatorëve të rijë.

Gjate vitit 2021 është paraparë të fillohen procedurat për riparimin e P2B në platon qendrore dhe E8B që aktualisht është në operim, me planifikimin që projekti të përmbyllet në vitin 2022.

Për më tepër, në 2021 do të fillojë zëvendësimi i shiritave të gjatë 1400 mm që shkojnë në drejtim të termocentraleve, duke instaluar një linjë të re 1800 mm.

Në vitin 2022 do të fillohet me riparimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve dhe ne program është që të vazhdoj riparimi i ekskavatorin E5M. Shiritat e dytë magjstral për në Kosova B duhet të zëvendësohen me 1,800 mm si edhe shiritat e qymyrit të sistemit i (1,600 mm në 1,800 mm) dhe III (1,400 mm në 1,800 mm).

Gjithashtu, zëvendësimi i shiritave me sisteme 1,800 mm duhet të përfundojë me shiritat e sistemit të djerrinës IV. Do të futet në punë ekskavatori i ri i dytë i qymyrit, i pasuar nga nxjerrja nga përdorimi i ekskavatorëve të vjetër E1B dhe E1M me shiritat vetëlëvizës përkatës.



## **b. Plani Zhvillimor dhe Investiv i TC Kosova A**

De-Komisionimi i pjesëve jothelbësore:

Sipas Strategjisë së Energjisë të Kosovës 2017 - 2026 parashikon ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe de Komisionimi e TC Kosova A, për arsye të ndryshme dhe procesit tashmë të deklaruar të dështimit për ndërtimin e TC Kosova e Re, pritet të ri shkruhet një strategji e re në këto rrethana të reja, ku duhet bazuar në resurse vendore dhe vendimarrja për të ardhmen e TC Kosova A është mëse jetike.

Tashme të gjitha njësive të këtij TC i kanë kaluar jetëgjatësinë e tyre, gjithashtu është në proces e sipër de-komisionimi dhe çmontimi i objekteve të gazifikimit, azotikut, ngrohtores dhe objekteve tjera që nuk e pengojnë operimin normal të njësive aktive të TC Kosova A, në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/156 “Shfrytëzimi i linjitit në pajtim me të gjitha kërkesat të mbrojtjes mjedisore (ndërtimi, rehabilitimi dhe rindërtimi i kapaciteteve gjeneruese) duhet të plotësoj kriteret mjedisore siç është përcaktuar në komunitetit e energjisë e që janë pasqyruar në kriteret e BE-së: 04/156.” Zgjatjen e jetës së operimit të TC Kosova A për një periudhë se paku 25 vjeçare apo një operim nga 10 deri 15 vjet si faze tranzitore deri në adresimin e sigurisë së furnizimit për vendin tonë. Kësaj zgjatje është duke i paraprijë një studim i fizibilitetit, që është në proces.

## **c. Plani Zhvillimor dhe Investiv i TC Kosova B**

Investimet në TC Kosova B kryesisht bazohen në Studimin e Fizibilitetit për rindërtimin e këtij TC. Gjithashtu, duhet të kryhen edhe investime të tjera të cilat duhet të realizohen paralelisht. Si investimet në kaldaja, turbinat, gjeneratorin elektrik, instalimet elektrike, kondensator, sistemin e ujit furnizues dhe në strukturat ndërtimore. Plani i investimeve për ndikimet ambientale përfshinë:

- Implementimi i projektit të DeNOX-it, Elektrofiltrave dhe transportit të brendshëm të hirit;
- Trajtimi i ujërave shkarkuese nga TC Kosova B;
- Zvogëlimi i grimcave të pluhurit – Filtrat Elektrostatik (ESP);
- Masat për zvogëlimin e emisionit të pluhurit;
- Masat për zvogëlimin i NOx;
- Masat për zvogëlimin e SO<sub>2</sub> (FGD);
- Masat për trajtimin e ujërave të ndotura.

#### **d. Burimet e Ripërtrishme**

Prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe plani i ndërtimit të parkut solar prej 100 MW me mundësi zgjerime për pjesët tjera në hapësirat e pashfrytëzuara për qëllime operative.

### **Ambienti**

KEK mbetet i përkushtuar në realizimin e investimeve në ambient dhe në përmirësimin e mjedisit ku zhvillon aktivitetin e vet. Gjatë vitit janë zhvilluar projektet e mbjelljes së plantacioneve me fidanë dhe mirëmbajtjen e tyre. Në këtë drejtim janë zhvilluar edhe disa projekte të cilat kanë pas për qëllim rritjen e mbulueshmërisë me zona të gjelbërta, si investimet në shiritin e gjelbër përreth TC Kosova A, që do të ndikoj në përmirësimin e ajrit.

Në bazë të matjeve të evidentuara në gjashtë stacionet monitoruese përreth ish deponisë së hirit të Kosovës A, gjatë periudhës së kaluar, trendi i rënies së nivelit të pluhurit total të depozituar në ajër ka vazhduar, duke qenë gjithnjë brenda nivelit të kufijve të lejuar. Gjatë vitit 2020 janë vazhduar kontaktet me BE për projektet e filluara për qëllime ambientale dhe mjedisore, të cilat pritet të realizohet përmes fondeve IPA2019.

KEK gjatë vitit 2020 me vlerësimet e bëra për njohjen dhe matjen e provizioneve të ambientit, ka planifikuar që me buxhetin e vet të shlyej këto detyrime vit pas viti dhe të kryej investime në ku në bazë të vlerësimeve të arsyeshme, duke marr parasysh edhe vlerën në kohë të parasë, në rreth 10 vitet e ardhshme KEK pret që të ketë një dalje të parasë në vlerë €28.73 milion për çështje që lidhen me ambientin. Këto përfshijnë pastrimin dhe përmirësimin e tokës, ri kultivimin e tokave pyllëzimin e djerrinave, trajtimin e materieve të rrezikshme, asbestit, vajrave, trajtimin e ujërave etj.

### **Plani i Divizionit të Mihjeve**

Gjatë vitit 2021 Divizioni i Mihjeve planifikon 8.5 milionë ton prodhim të qymyrit dhe 13.0 milionë ton të djerrinës, duke furnizuar termocentralet me qymyr në sasi të duhur dhe në kohë, si dhe mbajtjen e rezervave të qymyrit në sasinë e planifikuar .

Tabela e planit të biznesit 2021 për këtë divizion është si vijon:

Nr.	TREGUESIT KRYESORË TË PËRFORMANCËS	Njësia	Plani për vitin 2021
1	<b>Sibovci Jug-perëndimor</b>		
	Prodhimi i qymyrit	ton	<b>8.500.000</b>
	Zhvendosja e djerrinës	m <sup>3</sup>	<b>13.000.000</b>

**Tabela: Plani i Biznesit 2021 Divizioni i Mihjeve**

Sasia dhe cilësia e thëngjillit planifikohet duke u bazuar në bilancin energjetik, dhe sasia e djerrinës përcaktohet bazuar në konfigurimin e terrenit.

### **Plani i Divizioneve të Gjenerimit te Energjisë**

Plani për prodhimin e energjisë elektrike është zhvilluar në bazë të Bilancit Vjetor Energjetik të KEK-ut. Për realizimin e planit, kusht kryesor është furnizimi i vazhdueshëm i thëngjillit në sasi të duhura dhe me cilësinë e duhur, në përputhshmëri me planin e pajtuar edhe me Divizionin e Mihjeve.

Tabela e planit të biznesit 2021 për Divizionin e Gjenerimit është si vijon:

Nr.	TREGUESIT KRYESORË TË PËRFORMANCËS	Njësia	Plani për vitin 2021 (MESATARJA/TOTALI)
1	<b>DISPONUESHMËRIA</b>	%	
	A3	%	<b>58.0</b>
	A4	%	<b>58.0</b>
	A5	%	<b>64.0</b>
	B1	%	<b>95.0</b>
	B2	%	<b>95.0</b>
2	<b>GJENERIMI BRUTO</b>	<b>MWh</b>	
	Kosova A	MWh	2,163,744
	Kosova B	MWh	3,045,068
3	<b>GJENERIMI NETO</b>	<b>MWh</b>	
	Kosova A	MWh	1,904,000
	Kosova B	MWh	2,752,728

**Tabela: Plani i Biznesit 2021 Divizioni i Gjenerimit**

## ***Ndikimet e Jashtme në Planin e Biznesit***

Viti 2020 është shoqëruar me sfida të ndryshme që kanë pasur një ndikim në planin e biznesit, dhe sidomos në realizimin e projekteve kapitale, të cilat cila gjatë 2020 është realizuar me €36.9 milion krahasuar me 34,45 në 2019. Edhe pas 2020 për korporatën sfidat kryesore vazhdon të mbetet:

- Për shkak të vjetërsisë së kapaciteteve aktuale gjeneruese, sfida mbetet mbajtja e prodhimit të energjisë në sasinë e planifikuar për ta mbuluar gjithë kërkesën vendore. Gjatë vitit 2020 me vonesa të theksuara dhe me impakt në ndalesat e paplanifikuara dhe në bilancin energjetik, është bërë pranimi teknik i remontit kapital të bllokut A3. Po ashtu, për shkak të procedurave të prokurimit, ka pas vonesa të theksuara në realizimin e remontit kapital të Bllokut A4, i cili gjatë 2020 nuk është kontraktuar edhe për shkak të ankesave të shumta sipas LPP.
- Aktualisht KEK ballafaqohet me konteste të shumta gjyqësorë të cilat bazohen kryesisht në interpretime të kaluara ligjore dhe zbatimin praktik të ligjit të punës ose me konteste të ndryshme në zbatimin e tij. Rastet përfshijnë edhe ish/punëtorëve të KEK, kryesisht raste të vjetra të cilat datojnë nga ndarja e distribucionit por edhe konteste të tilla për pagesat e orëve jashtë orarit dhe të vikendeve.
- Pensionimet e kuadrove me përvojë dhe vonesat në zëvendësimin e tyre ka ndikuar në arritjen në kohë dhe me cilësi të objektivave, duke shkaktuar vonesa në realizimin projekteve.
- Më 30 Qershor 2020, Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori vendim për shpalljen jo kushtetues të Ligjit 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me çka ndryshon edhe rrjedhën e pritshme të daljeve të parasë së gatshme sipas planeve të aprovuara.
- Ndryshimet e njëanshme të taksave/tarifave nga autoritet rregullatorë që ZRRE me aplikimin e tarifave për çasje në rrjetin e KOSTT –it e të tjera.
- Megjithëse, Pandemia shkaktoi çrregullime të mëdha në të gjithë ekonominë e vendit, sektori i minierave dhe ai i energjisë ku operon KEK ka mbajtur një nivel të lartë të realizimit të planit të prodhimit. Megjithëse kërkesat për zvogëlimin e stafit dhe mbajtjen e distancës kishin efekt në organizimin punës, efektet e tyre në realizimin e planit ishin minimale.

- Efektet tatimore të KEK në ekonominë e vendit janë të rëndësishme, gjatë vitit 2020 ka paguar €3,08 milion krahasuar me € 2,75 milion në 2019.
- Një ngjarje me ndikim pozitiv për KEK, që erdhi si rezultat i pandemisë ishte aprovimi i ligjit nr.07/L-016 për rimëkëmbje ekonomike- Covid 19, në nenin 14 të tij, i liron nga detyrimi për pagesë të rentës minerare të gjitha subjektet që obligohen ta paguajnë këtë rentë sipas nenit 58 të ligjit për Miniera dhe minerale nr.03/L163 i plotësuar /ndryshuar me ligjin nr.04/L-158, për periudhën 01 Janar- 31 Maj 2021. Kjo do të jetë një masë e rëndësishme stimuluese për objektivat afatgjata të KEK në realizimin e projekteve si Hapja e Minierës së Re dhe Revitalizimi i TCB. Sipas përlllogaritjeve 10.6 milion do të jenë shkurtime në shpenzimet e tantumës për pesë muaj 2021.
- Realizimi i investimeve strategjike në ndërrimin e elektro-filtrave në TCB të planifikuara të realizohen sipas planit të paraparë për vitin 2020 fillimisht janë shtyrë fillimisht për vitin 2021, pastaj në shkurt të këtij viti janë shtyrë sërish për vitin 2022. Kjo ka bërë që bilanci energjetike të ndryshojnë dhe rrjedhimisht edhe plani buxhetor për vitet respektive.
- Vështirësi në realizimin e projekteve kapitale edhe në divizionet të tjera të cilët kanë qenë të planifikuara të realizohen gjatë 2020.
- Përkundër që minierat e KEK qëllim primar kanë prodhimin e thëngjillit për nevojat e termocentraleve të veta KEK e ka pas të planifikuar shitjen e thëngjillit. Rënia e kërkesës për thëngjill si rezultat i pengesave në qarkullim gjatë vitit 2020 dhe vështirësitë në inkasimin nga ana e Kosova thëngjillit kanë pas efektet e veta në mosrealizimin e planeve për shitjen e thëngjillit tek palët e treta.

## Menaxhimi i rreziqeve të Korporatës

Rreziqet e korporatës janë ato ngjarje që ndikojnë në arritjen e objektivave të paracaktuara të KEK. Sipas kërkesave të ligjit 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, rregulloren e MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e rreziqeve, KEK ka identifikuar rreziqet e veta sa i përket njësive të biznesit dhe njësive mbështetëse duke mbajtur fokusin në minimizimin e tyre dhe në menaxhimin sa më të mirë që të ketë mundësi të ruaj kursin drejt realizimit të objektivave pa kosto të paparashikuara ose me kosto sa më minimale.

*Palët e interesuara duhet ti kushtojnë vëmendje këtyre treguesve të rrezikut të identifikuar nga burime të brendshme të vlerësimit dhe mbi këto informata dhe të dhënat historike mund të ndikojnë në opinionin e tyre lidhur me ecurinë e KEK-ut në të ardhmen, dhe përpjekjeve që KEK është duke bërë për ruajtjen e vazhdimësisë në rritjen e vlerës për aksionarin, nën vëmendjen e ekzistimit të rreziqeve të cilat bartin pasiguri dhe ngjarje që mund të afektojnë arritjen e synimeve.*

Viti 2020 karakterizohet tashmë nga pandemia e Covid 19 si dhe e përcjellë me një ndryshim të vazhdueshme politike në vend të cilat kanë ndikuar në strategjinë afatgjatë të korporatës.

**Covid-19** – gjatë periudhës mars-qershor 2020 kur vendi ishte i mbyllur si rrjedhojë e pandemisë, u dhanë efektet e para në raporte partneriteti me palët e tjera. Efektet e pandemisë së virusit covid-19, në ekonominë vendore edhe si rezultat i masave të marra për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kanë dhënë efekt që vazhdojnë të ndjehen edhe gjatë vitit 2021 në realizimin e planeve financiare të KEK në vitin 2020. KEK ka themeluar Komitetin e Sigurisë për të menaxhuar dhe përcjell nga afër rreziqet e situatës së pandemisë, duke marr masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së sëmundjes tek punëtorët e korporatës. Disa nga aktivitetet e shtuara si rrjedhojë e rekomandimeve të IKSH, ishin dezinfektimi i hapësirave, testimi i punonjësve për infektim, etj. Megjithatë, disa nga efektet e para që janë vërejtur nga pandemia që në fillim:

- a) Pamundësia e realizimit të projekteve të rëndësishme strategjike për KEK të parapara të realizohen nga Prill 2020 si projekti Elektro-filtrave donacion nga BE me fondet IPA 2018. Zhvendosur për vitin 2022-23.
- b) Rritja e numrit të problemeve në projektet afatgjata kryesisht me ato të ndërlidhura me Pandeminë.
- c) Projekte të ndërlidhura me revitalizimin e TCB furnizimet dhe prodhimet e materialeve dhe pajisjeve për këtë qëllim.

- d) Rreziku i kreditimit- realizimi i të hyrave të faturuara me kohën. KEK gjatë vitit 2020 ka pasur një prodhim stabil dhe për shkak të natyrës së tregut e tërë energjia është shitur në vend me përjashtim të tepricave-energji e natës, të cilat janë eksportuar. KEK ka pas vonesa në realizimin e të hyrave nga shitjet për USS dhe Mbulimin e Humbjeve e cila ka ardhë si rezultat i vonesës së pagesave nga konsumatorët, e ardhur po ashtu nga mbyllja e ekonomisë si masë e ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për menaxhimin e pandemisë në muajt Mars-Qershor 2020.
- e) Ndryshime në strukturën e të konsumit të energjisë elektrike, duke zvogëluar konsumin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve dhe rritja e kërkesës për energji për USS.
- f) Rritje e kostove operative për kategori të identifikueshme dhe që i atribuohen kryesisht pandemisë: të tilla si shpenzimet e personelit, desinfektimi i hapsirave, masat mbrojtëse për punëtorë, testimet e punëtorëve etj.

Ndikimet e COVID-19 në aspektin e menaxhimit dhe kryerjes së punëve nga distanca përmes rritjes së komunikimeve dhe marrjes së vendimeve përmes platformave online, ka shkaktuar një ndryshim të madh në kulturën e punës brenda organizatës. Gjatë vitit 2020 sidomos në muajt Mars-Prill 2020 KEK kishte rreth 830 punëtorë më pak në punë si rezultat i vendimeve të Qeverisë për mbrojtje ndaj pandemisë si kufizimet e numrit të personave për hapësirë të caktuar, kujdesit ndaj fëmijëve/familjes, rastet personave të rrezikuar nga infektimi e që janë me sëmundje kronike, staf tjetër i kategorizuar si jo-esencial dhe punë nga shtëpia, etj.

Gjatë muajit Dhjetor 2020 KEK ka filluar me procesin e menaxhimit të rreziqeve. Kjo procedurë ka filluar me vlerësimin e rreziqeve aktuale dhe identifikimin e rreziqeve të reja të mundshme. KEK ka pas për synim identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve aktuale dhe të ardhshme si dhe krijimin e një kulture për përgjigje ndaj situatave ku rreziqet e ndryshme mund të ndikojnë në realizimin e objektivave afatgjata të ndërmarrjes:

### ***Identifikimi i rreziqeve***

Sipas rregullores, organizata obligohet fillimisht të njoh rreziqet e mundshme që më pas të merret me to. Kjo arrihet përmes shtjellimit të situatave në nivele të ndryshme të vendimmarrjes ose zbatuese lidhur me atë se se çfarë mund të ndodh? Ku, kur dhe si mund të ndodh?



Organizata përgjithësisht përballet me disa lloje të rreziqeve të cilat janë të grupuara në listën e rreziqeve në aneks të raportit. Në vijim, në mënyrë të përmbledhur sipas kategorizimit të rreziqeve, përshkruajmë këto gjetje:

- a) **Rreziqet Strategjike si:** këto janë rreziqe për të cilat niveli i vendimmarrjes është në nivel të Bordit të Drejtorëve. Prandaj në këtë kategori hyjnë: kultura dhe qeverisja korporative, planifikimi jo adekuat/ tejkalimi buxhetit, konkurrenca e jashtme, vendimmarrja për ndryshimet në politikën e çmimeve, transparenca dhe informimi i aksionarit, përgjegjësia shoqërore e organizatës etj. Gjatë vitit 2020 si rrjedhojë edhe e ndryshimeve politike në nivel vendi, KEK kishte ndryshime të shpeshta në organin mbikëqyrës dhe vendimmarrës për strategjinë e KEK. Problematike në aspektin strategjik mbetet e ardhmja e TCA dhe në këtë pikë realizimi sa më i shpejtë i projektit të studimit të fizibilitetit të saj do të ndikoj në biznesin e KEK në përcaktimin dhe realizimin e objektivave të korporatës. Blerja e pajisjeve për Minierën e Re ka pas një ecuri të mirë gjatë vitit 2020 e cila ka kulmuar me hartimin e specifikacionit teknik për blerjen e dy ekskavatorëve nga ana e konsulentëve të angazhuar përmes USAID, nga marrëveshja e mirëkuptimit me MZHE. Si rrjedhojë edhe e orientimeve të KEK për rritjen e efikasitetit dhe performancës, Bordi i Drejtorëve së bashku me menaxhmentin ka vendosur të realizoj rishikimin funksional të skemës organizative të KEK sha e cila është në proces dhe vazhdon të realizohet gjatë 2021.
- b) **Rreziqet financiare si:** gjendja e përgjithshme ekonomike në vend reflekton në biznesin e korporatës në disa aspekte si: realizimi i të hyrave, likuiditeti/paraja e gatshme, raportimi dhe kontrolli financiar, çmimet e karburanteve, ndryshimet në rregullat e industrisë zbatuar nga ZRRE, kostot e prodhimit jo-konkurruese/mos pranimi i kostove të prodhimit në çmimet e energjisë, ndryshimi në normat e interesit, etj. Niveli i vendimmarrjes është i menaxhmentit /BtD.
- c) **Rreziqet operative si:** probleme me mungesën e burimeve njerëzore si dhe mosha mesatare e lartë e punëtorëve, probleme në rrjetin e furnizimeve dhe në menaxhimin e kontraktimeve, dështime në realizimin e kontratave, mosfunksionim i pajisjeve kryesore, gabime të operatorëve /dëme aksidentale, probleme në funksionimin e kontrolleve të brendshme, vjedhja dhe mashtrimet, etj. Niveli i vendimmarrjes është i menaxhmentit.
- d) **Rreziqet e përputhshmërisë si:** detyrimet e drejtorëve dhe zyrtarëve lartë të korporatës për përputhshmërinë e rregulloret dhe ligjet e aplikueshme si dhe funksionimin e mirë të kontrolleve të brendshme, mbrojtja e shëndetit dhe siguria e punëtorëve ishin rreziqe të theksuara dhe kritike

gjatë 2020, detyrimet ndaj palëve të treta për rastet e arbitrazhit, detyrimet për kontestet ligjore nga punëtorët e cila përkundër trajtimeve të vazhdueshme në 2020 ka pas një rritje nga 2019, detyrimet për trajtimin e asbestit, detyrimet për mbrojtjen nga ndotja atmosferike e tokës/ujit dhe ajrit, rreziqet e katastrofave natyrore, raportimi rregullativ etj.

- Në Nëntor 2020 KEK ka pranuar raportin përfundimtar për vlerësim të riskut, nga kompania konsulentë e angazhuar për të siguruar informata dhe specifika lidhur me tregjet ekzistuese të sigurimeve dhe mundësitë e sigurimit të aseteve qenësore të KEK-ut nën kushtet e tyre fizike. Ky raport bazohet në kushtet dhe praktikën e vëzhguara dhe informacionin e vënë në dispozicion në kohën e studimit vlerësues. Ky studim përfshiu një rishikim të gjendjes së ndërtesave, operacioneve, rreziqeve natyrore dhe sistemeve të mbrojtjes nga zjarri duke përjashtuar sigurinë e jetës. Studimi gjithashtu përfshiu një rishikim të kontrolleve administrative të tilla: si inspektimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, dëmtimet e këtyre sistemeve dhe planifikimi i emergjencave të mbrojtjes nga zjarri.
- Gjatë studimit në terren, rreziqet janë konstatuar të jenë brenda konceptit të zbutjes së rrezikut. Objektet e shqyrtuara gjatë studimit konsiderohen në gjendje mesatare të krahasuar me impiante shtetërore që përdorin teknologji dhe kane moshë të ngjashme. Megjithatë, për shkak të moshës, këshillohet fuqimisht që një rehabilitim gjithëpërfshirës me domethënës duhet të planifikohen investime në të gjithë impiantet kyqe.
- Në këtë raport janë dhënë edhe rekomandimet specifike për formulimin (ose përmirësimin ekzistues) të Programeve të Menaxhimit si dhe sigurimin (ose rritjen) e masave mbrojtëse fizike për të kontrolluar rreziqet specifike kryesisht të analizuara nga pikëpamja dhe fushëveprimi i këtij raporti.

*Për shkak të riskut, vlerës së lartë të parashikuar të primit dhe kufizimeve të tregut të sigurimeve, deri tani nuk kemi arritur të bëjmë sigurimin e aseteve. Për këtë arsye, me kërkesë të Aksionarit, me qëllim të dhënies së informacioneve që do të mundësojnë re-siguruesit kredibil të ofertojnë për shitje të polices së sigurimit, kemi kontraktuar shërbimet për vlerësim të riskut në KEK. KEK është në proces të shqyrtimit të opsioneve për arsyeshmërinë dhe mundësinë e blerjes së polices së sigurimit nën kushtet e kostos së lartë në raport me përfitimet e pritshme.*


## ***Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të çmimeve***

Ndjeshmëria e ndërmarrjes ndaj rrezikut të ndryshimit të çmimeve i ka të bëjë me shkallën e ndryshimit në kërkesën e konsumatorit si rezultat i ndryshimit të çmimit të produktit.

Gjatë vitit 2020 përkundër kërkesave fillestare për rritjen çmimit me fokus në reflektimin e kërkesave të brendshme për investime si dhe me qëllim reflektimin e kostove të KEK, me vendim të BtD dhe me qëllim reflektimin e sugjerimeve të ZRRE për mos ndryshim të çmimeve për të mos ngarkuar konsumatorët me kosto shtesë, si rrjedhojë edhe e rënies ekonomike nga COVID -19, janë aprovuar çmimet e shitjes së energjisë elektrike, të njëjta me ato të vitit paraprak, respektivisht për USS 29,5 €/MWh, për mbulimin e humbjeve 36 €/MWh.

Megjithatë efektet e ndryshimeve në çmimin e energjisë në tregjet ndërkombëtare si refleksion i rënies ekonomike globale të shkaktuar nga pandemia, janë vërejtur në çmimin e energjisë së eksportit i cili si mesatare në vitin 2020 ishte 30.7 €/MWh krahasuar me atë të 39.63 €/MWh në vitin 2019.

Kërkesa për produktit të energjisë elektrike si produkt i domosdoshëm nuk është i ndjeshëm ndaj ndryshimit të çmimit. Duke qenë se e gjithë sasia e prodhuar shitet, dhe mbi 85 % e energjisë së prodhuar shitet në vend, sasia e kërkuar pritet të rritet në varësi të rritjes ekonomike. Të hyrat e korporatës janë të ndikuara nga kapacitetet prodhuese, stabiliteti i tyre dhe nga niveli i çmimit. Gjatë vitit 2020 çmimi mesatar i energjisë ishte 30.8 € për MWh, ndryshimi në çmimin mesatar të energjisë elektrike me  $\pm 1\text{€}$  do të kishte një lidhje pozitive lineare me një efekt konstant të ndryshimit prej  $\pm 3.3\%$  në të hyrat e realizuara për vitin nën supozimin se prodhimi realizohet sipas plani për vitin 2021.



Nga Maji i vitit 2013, KEK nuk importon energji elektrike për të mbuluar deficitin në bilancin energjetik të Kosovës, prandaj, ekspozimi ndaj rrezikut të mallit është i kufizuar vetëm në çmimet e eksportit të energjisë.

## ***Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të kreditimit***

KEK –u gjatë viti 2020 është i ekspozuar ndaj rrezikut të kreditimit si rrjedhojë e aktiviteteve të veta të shitjes. Vonesat në mbledhjen e detyrimeve nga ana e konsumatorëve nga ana e KESCO si rrjedhojë e kufizimit të lëvizjes, mbylljes së ekonomisë në periudhën Mars- Qershor 2020 ka shkaktuar vonesa në pagesën e faturave ndaj KEK. Rreziku është i mundshëm nga rritja e gjasave për mos shlyerje të detyrimeve kontraktuale sipas marrëveshjeve dhe afateve të pagesës së paraparë me faturim. Sipas gjendjes më 31 Dhjetor 2020 llogaritë e arkëtueshme nga konsumatorët vendor, konsumatorët e huaj dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme, janë rritur në € 40.85 milion nga € 22,61 milion sa ishte në vitin 2019. Kryesisht janë borxhe të prapambetura nga KESCO, KEDS, Kosova Thëngjilli.

Shitjet vendore, kompania merr garanci kur është e përshtatshme për të zbutur rrezikun e kreditimit. Politika e kompanisë është që të operoj me kushte të kredisë që variojnë nga 30 deri në 90 ditë.

Të arkëtueshmet tregtare përbëhen nga një numër i vogël i konsumatorëve, prandaj edhe kushtet e kredisë menaxhohen me monitorim individual të blerësve për çdo muaj.

Ndërsa sa i përket eksportit të energjisë, kompania ka marr masa për transferin e rrezikut të kreditimit të shitjes së eksporteve përmes mbulimit të shitjeve me garancione të përmbushjes. Po ashtu shitjet realizohen strikt sipas rregullave të aprovuara nga ZRRE dhe me operatorë të licencuar.

Megjithatë rreziku i kredisë për para dhe ekuivalentë të saj konsiderohet i papërfillshëm, pasi palët janë banka me reputacion dhe në përgjithësi sektori bankar në Kosovë konsiderohet me stabilitet të lartë. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë pasqyrohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

## ***Ekspozimi i ndërmarrjes ndaj rreziqeve të likuiditetit***

Rreziku i likuiditetit dhe rrjedhës së parasë ka të bëjë me aftësinë e kompanisë për të gjeneruar mjete të mjaftueshme për të shlyer detyrimet e veta afatshkurtër. Këta tregues financiar monitorohet në mënyrë të kujdesshme dhe raportohen në baza periodike tek organet mbikëqyrëse dhe tek aksionari. Gjatë vitit 2020, përkundër rritjes së llogarive të arkëtueshme nga vonesat në pagesën e faturave rrjedhëse, kryesisht nga konsumatorët e vet kryesor KESCO dhe KEDS, KEK ka pasur një nivel të lartë likuiditetit, kjo edhe si rrjedhojë e mos realizimit të disa nga projektet kryesore investive të cilat janë shtyer për vitet vijuese për shkak të

pandemisë, duke ulur nivelin e kërkesave për daljen e parasë së gatshme por edhe si rrjedhojë e rritjes së shitjeve.

Niveli i kapitalit punues neto sipas gjendjes më 31 Dhjetor 2020 si normë e paraqitur nga ndryshimi i pasurive rrjedhëse me detyrimet rrjedhëse është € 94.51 milion, si dhe acid test ratio = 3.19, çka e bënë kompaninë të pa ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit dhe të aftë të shlyej shpejt detyrimet e veta afatshkurtra. Kompania po ashtu ka flukse të rregullta hyrëse të parave nga aktivitetet e veta dhe nuk pritet në periudhë afatshkurtër ndonjë ndërprerje a rrezik nga rrjedha e parasë së gatshme brenda vitit. EBITDA si tregues i aftësisë për të investuar në rritjen e vlerës dhe likuiditetit, kap vlerën € 67.44 milion në vitin 2020, krahasuar me € 60.1 në vitin 2019. Më poshtë tregues tjerë të likuiditetit:

Raportet/normat likuiditetit	2020	2019	2018	2017	2016
Paraja e gatshme në €'000	67,929	67,207	62,715	89,609	63,305
Neto kapitali punues në €'000	94,511	77,364	69,668	97,608	76,489
Borxh/ekuitet	0.85	1.05	1.28	1.55	2.02
Norma rrjedhëse	3.77	3.27	2.80	3.62	3.17
Acid test	3.19	2.66	2.3	3.1	2.5

## RAPORTIMET SHITESË PËR AKSIONARIN

### Qeverisja korporative

KEK Sha operon në tregun e energjisë si ofrues i të mirave publike nën rregullat e qeverisjes korporative në përputhje me ligjet dhe aktet tjera ligjore për realizimin e qëllimit të vet afatgjatë që është misioni dhe vizioni i kompanisë. Përgjegjës për caktimin e strategjisë së organizatës është Bordi i Drejtorëve i caktuar nga aksionari. Bordi vendos për strategjinë e biznesit si dhe merret me zgjedhjen dhe monitorimin e menaxhmentit të lartë të kompanisë, i cili është i pavarur nga bordi dhe aksionari. Bordi luan rol mbikëqyrës për menaxhmentin përmes mekanizmave të ndryshëm. Për këtë qëllim kompania ka të themeluar komitetin e Auditimit i cili vepron në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit për NP dhe me praktikat më të mira të qeverisjes korporative.

Gjatë vitit 2020, me kërkesë të Bordit të Përkohshëm, KEK inicion rishikimin e planeve të veta afatmesme zhvillimore duke synuar të përgjigjet rrethanave të reja të krijuara në tregun e energjisë me tërheqjen nga investimi në projekti i Kosovës së Re, të Contour Global.

Për të qenë në përputhje me të gjitha rregulloret dhe për të vendosur dhe promovuar rregullat etike përmes procedurave të qarta të ofroj transparencë dhe të kërkoj llogaridhënien në aktivitetet e veta për realizimin e objektivave të biznesit, korporata ka të aprovuar dhe zbaton: Kodin e Qeverisjes Korporative, Kodin e Sjelljes dhe Etikës si dhe Kodin e Punës, të aprovuar nga viti 2015 dhe të obligueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e organizatës.

Së fundmi, ekzistojnë rregullore dhe procedura, që kanë të bëjnë me Financat dhe TI në veçanti, që rregullojnë procedurat organizative brenda korporatës. Gjatë vitit 2020 janë hartuar, rishikuar ose kanë filluar te zbatohen:

<b>Rregullorja</b>	<b>Qëllimi</b>
<i>Rregullorja për testimin e Aseteve për dëmtim</i>	Rregullimi i procedurave për testimin asetëve për dëmtim sipas SNRF. Është hartuar dhe konsultuar gjatë 2020 dhe është aprovuar në 2021 me efekt nga viti 2020.
<i>Rregullorja për menaxhimin e mjeteve Themelore</i>	Rregullon procedurat e menaxhimit të asetëve të KEK sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe sipas SNRF aprovuar në 2020
<i>Procedura për menaxhimin provizioneve</i>	Rregullimi i procedurave për njohjen dhe vlerësimin provizioneve të ambientit, ligjore dhe të stafit sipas SNK. Është hartuar dhe konsultuar gjatë 2020 dhe është aprovuar në 2021 me efekt nga viti 2020.
<i>Procedura për operimin e blloqeve</i>	Qëllimi i kësaj procedure është të përcaktojë procedurën e operimit të blloqeve, është draftuar në 2020
<i>Procedura për vlerësimin e jetëgjatësisë së asetëve</i>	Qëllimi i kësaj procedure është rregullimi i procesit të rishikimit të vlerës së mbetur të asetëve/jetës së dobishme të tyre. Është aprovuar gjatë 2020 dhe janë kryer aktivitet nga komisionet përkatëse
<i>Procedura për menaxhimin e rreziqeve 2020</i>	Procedura synon të rregulloj procesin e menaxhimit të rreziqeve në mënyrë që kompania të shmang ose minimizoj humbjet nga ngjarjet e ardhshme –Aprovuar në 2020
<i>Procedura për shitjen e energjisë</i>	Procedura synon të rregulloj procesin e shitjeve (kryesisht eksportin e energjisë) korporatës e draftuar gjatë 2020-në proces

## Funksionimi i kontrolleve të brendshme

### Sistemi kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut nga raportimi financiar

KEK ka të implementuara sisteme të kontrollit të brendshëm që mundësojnë shmangien e konfliktit të interesit dhe ndarjen e detyrave në atë mënyrë që ekzekutuesi i një aktiviteti dhe aprovuesi nuk mund të jenë i njëjti person. Këto janë të rregulluara me kodin e punës, rregulloren për aprovim buxheti dhe kontroll të shpenzimeve, rregulloren për menaxhim të rrezikut dhe rregullore të tjera operative të implelementuar

në përputhje me ligjet e aplikueshme në vend, dhe vazhdimisht mbahen nën monitorim nga vet drejtuesit që të shmangin e rasteve për tu ndodhur në situatë të tillë.

Megjithatë, disa nga procedurat e kontrolleve dhe monitorimeve sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nuk kanë funksionuar mirë gjatë vitit 2020 dhe si të tilla janë në proces shqyrtimi. Po ashtu aktivitete të zhvilluara për përgjegjësinë sociale nuk janë zhvilluar mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat ligjore lidhur me qëllimin e donacioneve / sponsorimeve në funksion të interesit publik duke mos e shfrytëzuar kategorinë e buxhetit të dedikuar për këto aktivitete. Për vitin 2020, kompania ka identifikuar gabimin në procesimin e lëndëve për pagesë ose në proces të regjistrimeve kontabël dhe është futur në proces të rishikimit të disa e proceseve për përmirësim dhe për të arritur vlerën më të mirë për paratë, në funksion të arritjes së objektivave të korporatës duke respektuar kërkesat ligjore dhe me nivel të përshtatshëm të etikës profesionale.

Korporata Energjetike e Kosovës është e ekspozuar ndaj mundësisë së gabimeve të procesimit dhe të raportimit financiar, e varur nga shumë faktorë. KEK ka kaluar në sistem të ri të menaxhimit financiar- ERP tek i cili kanë përfunduar konfigurimet financiare dhe është në proces të migrimit të të dhënave. Implementimi i suksesshëm i të cilit, ndër të tjera, pritet edhe zvogëlimi i gjasave të gabimeve të procesimit si dhe rritjen e transparencës përmes ofrimit të informatave të sakta, si dhe në kohë reale mundësojnë edhe kontroll efikas dhe gjithëpërfshirës të regjistrimeve, transaksioneve dhe raportimeve financiare. Ndërkohë, sfidë në implementimin e suksesshëm dhe të plotë të këtij sistemi mbetet mungesa e burimeve njerëzore.

## ***Zyra e Auditimit të Brendshëm***

Divizioni i Auditimit të Brendshëm në KEK është e themeluar në baze të Ligjit 06/L-021 dhe Ligjit të Ndërmarrjeve Publike 03/L-087 si njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të udhëheqësit të subjektit të sektorit publik. Auditimi i Brendshëm ka pavarësi funksionale nga menaxhmenti pasi që i përgjigjet Komisionit të Auditimit të Bordit të Drejtoreve të emëruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Duke pasur parasysh organizimin e ndërmarrjes (KEK-ut) dhe kompleksitetin e saj si njësi prodhuese dhe administrative, Auditimi i Brendshëm është e organizuar në tri departamente dhe atë:

- Auditimin e Brendshëm Financiar,
- Auditimin e Brendshëm Operativ dhe



- Auditimin e Brendshëm te Përputhshmërisë.

Sipas skemës organizative të Auditimit të Brendshëm, janë të paraparë 16 auditor të brendshëm duke përfshirë edhe Drejtorin, të cilët kryejnë auditime duke u bazuar në Planin vjetor të aprovuar nga Komisioni i Auditimit të Brendshëm dhe me disa raste edhe me kërkesa të veçanta që mund të vijnë nga Komisioni i Auditimit, Bordi i Drejtoreve apo Menaxhmenti. Skema e aprovuar nuk është plotësuar dhe mungojnë 5 Auditor, arsyeja e mos plotësimit të skemës ka qene Pandemia ku nuk kemi arritur që të rekrutojmë staf të ri si rezultat i rrethanave të krijuara nga virusi COVID-19.

Auditimit i Brendshëm gjatë vitit 2020 si të gjitha Divizionet në KEK dhe gjithë shoqëria në Republikën e Kosovës dhe mbarë botën, si rezultat i Pandemisë dhe virusit Covid-19, ka qene i përballur me pandeminë ku thuajse të gjithë auditorët e kane kaluar COVID-19 dhe një kohe të gjatë kane qene ne vete izolim, si rezultat i personave të kontaktit apo edhe kur kane qene vete të infektuar. Po ashtu një kohe është punuar edhe me rrotacion sipas vendimeve të Qeverisë dhe rekomandimeve të IKSHP-se. Pavarësisht kësaj ne kemi arritur që të realizojmë angazhimet të parapara në kuadër të planit vjetor të aprovuar të cilin plan e kemi rishikuar në gjashtë mujorin e dytë. Për më shumë do i paraqesim në pika të shkurta ne vijim aktivitetet e kryera gjatë vitit 2020: Janë hapur gjithsej 44 raste, prej të cilave 25 kanë qenë të bazuara në planin vjetor kurse 19 janë kryer në bazë të kërkesës, ku kërkesat kanë qenë nga Komisioni i Auditimit, BD dhe menaxhmenti. Të paraqitura në mënyrë tabelore si më poshtë:

Rastet	Raste të hapura	Plan Vjetor	Me kërkesë	Rekomandime për përmirësim të Procesit	Rekomandime për Masa disiplinore
2020	44	25	19	97	3

Ne këtë vit për shkak të pandemisë kemi patë shumë kërkesa nga Komisioni i Auditimit me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të kësaj situatë. Janë bërë vizita në terren në mënyrë që të verifikohet se a janë duke u respektuar masat dhe për këtë janë përpiluar raporte për Komisionin e Auditimit dhe menaxhmentin ku janë rekomanduar veprime për menaxhmentin në mënyrë të menaxhimit sa më të mirë të situatës së Pandemisë.

Auditimit i Brendshëm përveç detyrave të lartcekura ka përpiluar dhe dhënë Opinione profesionale për Komisionin e Auditimit në lidhje me: Pasqyrat Financiare, Regjistrimin, Elaboratin, Draft Buxhetin, Opinion mbi procedurat e Operimit të Bllloqeve, Tregtimit të energjisë, Përpilimi dhe aprovimi i procedurave të brendshme, etj. Po ashtu ka vazhduar aktivitetin në hetimin dhe parandalimin e mashtrimeve ku në vitin 2020 kishte rezultate në lidhje me në rast konkret.

## **Përmbledhja e të gjitha procedurave gjyqësore**

Në Zyrën Ligjore gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsejtë 279 padi (civile dhe penale) shuma e përgjithshme e të cilave sillet rreth €6.50 milionë. KEK-u ka qenë palë paditëse me lëndë. Numri i padive të palëve kundër KEK-ut arrin në 238 lëndë.

Në segmentin e aktgjykimeve gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsejtë 416 të tilla (të shkallës së parë, dytë dhe supreme) prej tyre 114 kanë rezultuar në favor të KEK-ut kurse 302 në favor të palëve.

Gjatë vitit 2020 është zgjidhur rasti i arbitrazhit me Ethos Energy, rasti i kontestit për pagesën e prapambetur për riparimin kapital të Bllokut A5 nga viti 2014. KEK ka vlerësuar se me arritjen e marrëveshjes jashtë jashtëgjyqësorë arrin të realizoj kursime nga procedurat e arbitrazhit. Për këtë rast është marr mendim dhe ka qenë e angazhuar edhe zyra e Avokatit Shtetëror, dhe me vendim të BtD është arritur marrëveshje ndërmjet palëve.

KEK si palë e paditur ((në €' 000)	2020	2019
Kontestet lidhur me Punësimin dhe shkëputjen e marrëdhënies së punës	8,727	8,820
Kontestet me furnizuesit	1,760	4,378
Kërkesa për kompensim për dëmtim prone	4,740	4,483
Kërkesa për shkëmbimin e energjisë	1,957	-
Të tjera	466	242
<b>Total provizione ligjore</b>	<b>17,650</b>	<b>17,923</b>

KEK-sha si pale paditëse ne vitin 2020 Janë ne procedurë këto raste :

Në segmentin e arbitrazhit, për vitin 2020 kemi një lëndë në procedurë kontesti në vlerë € 4.34 milion në mes të KEK sh.a dhe KESCO-sh.a për inkasimin e shitjeve për 8 ditët e Majit 2013 (1-8 Maj) që lidhen me ndarjen e Distribucionit nga KEK. Në bazë të vlerësimit të menaxhmentit vlera e kontestit mundë të shkojë deri në € 4.5 milion përfshirë shpenzimet e procedurës. Sipas vlerësimit ato i takojnë KEK-ut, dhe për këtë është proceduar me procedurë përmbartimore, e cila pas prapësimit nga KESCO, rasti ka kaluar në gjykatë, të cilën KEK e ka fituar. Pas kësaj KESCO ka dorëzuar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe gjatë 2020 pretendimi i KEK-ut është refuzuar, procesi pritët të vazhdoj gjatë 2021.

- Padi në bazë të aktgjykimit penal janë gjithsej 17 raste në vlerë 51,251.00 €.
- Civile janë gjithsej 33 raste të cilat arrijnë vlerën 6,476,144.00 €.
- Administrative janë gjithsej 11 raste të cilat arrijnë vlerën 11,629,639.42 €.
- Përmbartimore janë gjithsej 10 raste të cilat arrijnë vlerën 4,747,934.00 €.
- Ekonomike janë gjithsej 5 raste të cilat arrijnë vlerën 2,155,942.32 €.
- Lendet sipas ligjit mbi faljen e Borxheve të rrymës, përfaqësohen sipas MiM 2018 nga KESCO: Nr i rasteve aktuale 2834, me vlerë 7,080,121.00€ .

Siç shihet ndryshon vetëm në piken 4 pasi që të dhënat nga pika 4 i janë marr nga KESCO.

## Transaksionet e Konsiderueshme

Në kuadër të këtyre transaksioneve në tabelën e mëposhtme janë përfshirë 5 (pesë) transaksionet më të rëndësishme, me vlerë mbi €1.0 milionë, të cilat janë nënshkruar gjatë gjithë vitit kalendarik 2020, pa marrë parasysh realizimin e tyre.

Kontratat e Nënshkruara gjatë vitit 2020	Vlera e Publikuar
Demontimi ,blerja dhe montimi i zbarrave të statorit si dhe Komisionimi i gjeneratorëve G1 dhe G2 në TC Kosova B	6,472,991
Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë	4,482,903
Remonti kapital i kaldajës për bllokun A4	2,736,140
Ndërtimi i deponisë së re të hirit në fushën e Sitnices	1,158,674
Furnizim me pjesë ndërrimi të konstruksionit për mekanizmin e rëndë	1,099,995

Tabela: Transaksionet kryesore gjatë vitit 2020

## Raportet me KPMM dhe Institucionet tjera

KEK gëzon një gjendje të mirë financiare dhe vazhdon të paguaj detyrimet e veta sipas maturimit. Sipas nenit 58 të ligjit për Miniera dhe minerale nr.03/L163 i plotësuar /ndryshuar me ligjin nr.04/L-158, KEK obligohet ta paguajnë rentën minerare në vlerë 3€/Ton tërëgjatë të eksploator. Gjatë vitit 2020, si rezultat i prodhimit më të lartë KEK ka krijuar shpenzime për rentën minerare në vlerë prej €25,62 milion, krahasuar me € 24,2 milion në vitin 2019. KEK bën matjet gjeodezike dhe në bazë të tyre e raporton eksploatimin e tërëgjatë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Poashtu, KEK dorëzon raporte të rregullta sipas kërkesave ligjore në KPMM, përfshirë pasqyrat financiare.

KEK ka kredi ndaj Ministrisë së Financave të cilën e paguan në dy kështe vjetore sipas marrëveshjes së ri programimit të borxhit me MF të vitit 2015. Po ashtu gjatë vitit 2020 KEK ka gjeneruar të ardhura neto prej € 23.78 milion të cilat rezultojnë me shpenzime për tatime në vlerë prej € 4.7 milion.

Gjithsej, në raport me institucionet shtetërore detyrime të drejtpërdrejta të njohura dhe të shlyera gjatë vitit 2020 kapin vlerën € 46.42 milion (2019: € 41.9 milion).

Institucioni	Lloji i shpenzimit/detyrimit	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
KPMM	Tantiema/ taksa e linjtit	(25,623)	(24,200)
MF	Interesi	(3,006)	(2,661)
MF	Kthimi Huazimit	(11,387)	(10,876)
ATK	Tatimet ne te ardhura	(4,707)	(3,073)
ZRRE	Taksa vjetore e licencës	(1,244)	(1,204)
Gjithsej		(46,417)	(41,937)

## SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR TË ARDHMEN

Korporata energjetike e Kosovës si ndërmarrje publike ballafaqohet me sfida të natyrave të ndryshme në përballje me të cilat, përkundër performancës së mirë financiare në vitet e fundit, do ti duhet përkrahja e aksionarit. KEK ka një nivel të lartë të parasë së gatshme në dispozicion për projektet e veta afatgjata, të cilat janë edhe të zotuara për realizimin e projekteve për të rritur sasinë dhe stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Sfidat e korporatës mund të jenë të ndryshme dhe ato ndikohen nga faktorët natyror (kushtet e ndryshme atmosferike), planifikimi jo i mirë, dhe pamjaftueshmëria buxhetore, pamundësia e çasjes në burime të jashtme financimi, etj. Disa nga sfidat kryesore me të cilat KEK do të ballafaqohet në të ardhmen e afërt mund të listohen si vijon:

- Tërheqja e Contour Global nga investimi në projektin e Kosovës së Re, ka ndikuar në planet e akterëve të tregut energjetik të Kosovës. Nevoja për një vizion qartë të KEK dhe Aksionarit për fatin e TC Kosova A, për sigurimin e kapaciteteve të reja afatgjata të nevojshme për mbulimin e tërë kërkesës vendore për energji përbën një sfidë.
- KEK ka pranuar gjatë vitit 2019 projektin e Minierës së Re, hartuar nga Consorciumi Mibrag GmbH, Gjermani. Për realizimin e së cilës, për shkak të vlerës së madhe (rreth 400 milion € në 5 vitet e ardhshme) KEK iu është drejtuar Aksionarit me kërkesë për përkrahje financiare gjatë 2019 dhe 2020. Realizimi i investimeve në kohë dhe me cilësi përbën sfidë për zhvillimin e minierave të KEK. Miniera ekzistuese bazuar në planin xehetar ka rezerva dhe teknikisht është e mundshme që të operoj me kapacitetet ekzistuese deri në vitin 2027. Çka e bën të domosdoshme rishikimin e investimeve dhe burimeve financuese në drejtim të hapjes së Minierës së Re.
- Mos-implementimi në tërësi i planit plotësues xehetar në divizionin e mihjeve për minierën Sibovci Jug-Perëndim mbetet çështje për t'u adresuar, edhe pse vazhdimisht investohet në këtë drejtim.
- Gjatë vitit 2020 KEK ka filluar procesin e rishikimit funksional të skemës organizative ku me angazhimin e një konsulenti të pavarur synon të implementoj një skemë funksionale të përshtatshme për rrethanat e KEK dhe sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Kjo do ti hapte rrugë edhe zhvillimit dhe rritjes së KEK me kuadro të reja dhe adekuate. Përkundër pritshmërisë, rishikimi funksional është duke vazhduar edhe gjatë vitit 2021, vonesat e përmbylljes së projektit u shkaktuan si rezultat i Pandemisë covid-19 si dhe të ndikuara edhe nga ndryshimet e shumta në Menaxhment dhe Bord të Drejtorëve të ndodhura gjatë vitit. Propozimet dhe implementimi i

skemave të reja sfidohen nga raporti i Mibrag për Minierën e Re, i cili rekomandon uljen e ndjeshëm të numrit të punëtorëve në DPQ nga 2700 në kohën e raportit (2563 më 31.12.2019), përmes ndryshimit të proceseve të punës dhe modernizimit gradual të tyre, të ulet në rreth në 1609 punëtorë, deri në vitin 2030. Megjithatë, problem mbetet ripërtërija e stafit në pikat kyçe, apo mungesa e programeve zhvillimore specifike për ato profesione, për të cilat punëtorët janë në prag të pensionimit.

*Një mundësi për korporatën që në sektorin e minierave por edhe në të tjerat të shikoj mundësinë të ul kostot e stafit si dhe njëherësh të përmirësoj proceset duke u angazhuar edhe në uljen e moshës mesatare të të punësuarve*

- Megjithëse, gjatë vitit 2020 nuk kishte probleme të theksuara në këtë drejtim Sfidë mbetet ende marrja e tokës për qellim të zgjerimit të minierave, zhvendosja e pronareve të tokave në ato zona dhe kostoja e prituri e projektit të shpronësimeve, probleme me komunitetin, ndotjen e ambientit, etj.

Në divizionet e gjenerimit sfidë është pamundësia e rrumbullakimit të investimeve të nevojshme të blloqeve punuese me qëllim të rritjes së gatishmërisë punuese dhe zgjatës së jetës së Termocentraleve.


- Përkundër aktiviteteve për përmirësimin e ambientit, për KEK mbetet sfidë financimi i vazhdueshëm në përmirësimin (zvogëlimin) e ndotjes minimale të ambientit, ku nevojiten përmirësime dhe ndërrime të pajisjeve në Termocentrale, që do të ulnin në minimum ndotjen e ambientin.
- për shkak të vjetërsisë së kapaciteteve aktuale gjeneruese, sfidë mbetet mbajtja e prodhimit të energjisë në sasinë e planifikuar për ta mbuluar gjithë kërkesën vendore me një operim stabil të blloqeve, duke operuar edhe me kosto efektive. Kjo bëhet e mundur me remontet e planifikuara të TC-ve, sipas planit operativ kur kërkesa për energji elektrike është e ulët, dhe kthimi në punë i blloqeve operuese sipas kohës së planifikuar.
- Mosrealizimi i projektit të BE –së në vitin 2020 paraqet sfidë për KEK për vonesën në realizimin e investimit të madh për ambientin por në aspektin financiar do të thotë një mundësi për konsolidim të mëtutjeshëm për zbatimin e projekteve të KEK që ndërlidhen me projektin e zgjatjes së jetëgjatësisë së TCB për shkak se ky investim ka 1 vit më shumë në kohë dhe mundësi e akumulimit

të rezervave për të realizuar projektin pa fonde të jashtme.

Investimet financiare në riparimet e blloqeve në TC A dhe TC B si dhe investimet në blerjen apo riparimin e teknologjisë punuese në Mihje janë të domosdoshme për një funksionalitet të mirë. Realizimi i investimeve të planifikuara nga konsulenti i angazhuar nga BE, Konsorciumi Eptisa për investime në Re-vitalizimin e Termocentralit Kosova B si dhe investimet e projektuara nga konsulenti Mibrag i angazhuar nga KEK-u për hartimin e projektit për hapjen e Minierës së Re, për shkak të vlerës së madhe të tyre nuk mund të mendohet pa përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes huadhënies afatgjatë për mbulimin e një pjese të projektit. Po ashtu në të ardhmen e afërt KEK synon përshtatjen graduale të çmimeve të energjisë elektrike për të mbuluar kostot e korporatës.

Fare në fund, pavarësisht sfidave, menaxhmenti i KEK-ut i mbetet besnik vizionit të korporatës që të realizoj prodhimin e energjisë elektrike i me kosto sa më të ulët dhe me ndikim minimal në ndotjen e ambientit.

## Struktura Organizative KEK Sh. A 2020



# Pasqyrat Financiare

të audituara për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

	Shënimet	Më 31 Dhjetor, 2020 (në EUR' 000)	Më 31 Dhjetor, 2019 (në EUR' 000)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	296,365	305,555
Asetet e paprekshme	5	221	44
		<b>296,586</b>	<b>305,599</b>
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Stoqet	6	19,841	20,725
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, neto	7	40,850	22,614
Tatimi në fitim i arkëtueshëm		-	899
Paraja në dorë dhe në bankë	8	67,928	67,207
		<b>128,619</b>	<b>111,445</b>
<b>GJITHSEJ ASETET</b>		<b>425,205</b>	<b>417,044</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>			
Kapitali aksionar	9	25	25
Rezervat	10	568,784	568,538
(Humbjet) e akumuluar		(391,403)	(415,187)
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>		<b>177,406</b>	<b>153,376</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet jo -qarkulluese</b>			
Huazimet pjesa jo - rrjedhëse	11	138,154	149,541
Grantet e shtyra	12	16,156	21,373
Provizionet	13	48,561	48,502
Detyrimet e tatimit të shtyrë	24	10,820	10,171
		<b>213,691</b>	<b>229,587</b>
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Huazimet pjesa rrjedhëse	11	12,051	12,009
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	14	13,799	15,259
Tatime në të ardhura të pagueshme		613	-
Shpenzimet akruale	15	7,645	6,813
		<b>34,108</b>	<b>34,081</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>247,799</b>	<b>263,668</b>
<b>GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET</b>		<b>425,205</b>	<b>417,044</b>

**Tabela: Bilanci i gjendjes, nga Pasqyrat Financiare të KEK ShA për vitin që përfundon më 31.12.2020 të Audituar**



	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (in EUR' 000)	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (in EUR' 000)
Shitjet	16	185,844	176,862
Të hyrat nga grantet	17	5,217	5,847
Të hyrat tjera	18	1,960	2,426
		<b>193,021</b>	<b>185,135</b>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(45,662)	(41,816)
Shpenzimet e personelit	19	(54,169)	(56,332)
Energjia elektrike dhe komunalitë	20	(16,630)	(17,923)
Kostot e mirëmbajtjes		(4,753)	(4,016)
Materialet dhe furnizimet		(7,780)	(3,557)
Shpenzimet e linjtit	15	(25,623)	(24,200)
Provizionimet për shlyerjen e inventarit	6	567	1,210
Humbjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve	27.B	1,012	(2,945)
Ndryshimet në provizione	13	1,898	2,474
Shpenzimet e tjera operative	21	(11,410)	(13,151)
		<b>(162,550)</b>	<b>(160,256)</b>
<b>Fitimi nga operacionet</b>		<b>30,471</b>	<b>24,879</b>
Të hyrat financiare (Shpenzimet), neto	22	(1,980)	(2,584)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>28,491</b>	<b>22,295</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	23	(4,707)	(3,073)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>23,784</b>	<b>19,222</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Zërat që nuk do të ri klasifikohen në fitim dhe humbje</b>			
Efekti i tatimit të shtyrë ne rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	24	246	(493)
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>24,030</b>	<b>18,729</b>

**Tabela: Pasqyra e të ardhurave, nga Pasqyrat Financiare të KEK ShA, për vitin që përfundon  
më 31.12.2020 të Audituar**

		2020	2019
	Shënimet	(në EUR 000)	(në EUR 000)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi neto para tatimit		28,491	22,295
Rregullimet për zërat jo monetar:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	45,662	41,816
Amortizimi i granteve	17	(5,217)	(5,847)
Të hyart nga interesi	22	(1,026)	(77)
Shpenzimet e interesit	22	3,006	2,661
Provizionimi i borxheve të këqija	7	(1,012)	2945
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensione	13	(1,898)	(2474)
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e stoqeve	6	(567)	(1210)
Shlyerja direkt e aseteve		785	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	261	17
<b>Fitimi para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative</b>		<b>68,485</b>	<b>60,126</b>
Zvogëlimi / (Rritja) në Stoque		1,451	(319)
Zvogëlimi / (Rritja) në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(16,341)	404
Rritja / (Zvogëlimi) në të pagueshmet tregtare dhe të tjera		1,329	(5,049)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>54,924</b>	<b>55,162</b>
Interesi i arkëtuar		143	77
Interesi i paguar		(2,964)	(2,668)
Tatimi në fitim i paguar		(3,085)	(2,750)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>49,018</b>	<b>49,821</b>
<b>Paraja nga aktivitetet investive</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4	(36,910)	(34,453)
<b>Paraja e përdorur në aktivitetet investive</b>		<b>(36,910)</b>	<b>(34,453)</b>
<b>Paraja nga aktivitetet financiare</b>			
Pagesa e huazimeve	11	(11,387)	(10,876)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare</b>		<b>(11,387)</b>	<b>(10,876)</b>
<b>Rritja / Zvogëlimi neto i ekuivalenteve të parasë</b>		<b>721</b>	<b>4,492</b>
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		67,207	62,715
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>8</b>	<b>67,928</b>	<b>67,207</b>

**Tabela: Bilanci i rrjedhjes së parasë nga Pasqyrat Financiare të KEK ShA, për vitin që përfundon më 31.12.2020 të Audituara**

	Kapitali aksionar (në EUR' 000)	Rezervat (në EUR' 000)	Humbjet e akumuluar (në EUR' 000)	Gjithsej (në EUR' 000)
Balanca më 1 Janar 2020				
Transaksionet me Pronarët	25	568,538	(415,187)	153,376
Transaksionet me Pronarët	-	-	-	-
Fitimi për Vitin	-		23,784	23,784
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	246		246
Total të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	246	23,784	24,030
Balanca më 31 Dhjetor 2020	25	568,784	(391,403)	177,406
Balanca më 1 Janar 2019	25	569,031	(434,409)	134,647
Transaksione me pronarët	-	-	-	-
Transaksione me Pronarët	-	-	-	-
Fitimi për Vitin	-	-	19,222	19,222
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	(493)	-	(493)
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	(493)	19,222	18,729
<b>Balanca më 31 Dhjetor 2019</b>	<b>25</b>	<b>568,538</b>	<b>(415,187)</b>	<b>153,376</b>

**Tabela: Kapitali, nga Pasqyrat Financiare të KEK ShA, për vitin që përfundon më 31.12.2020**  
**të Audituar**



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



## Bordi i përkohshëm i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.

Duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë ligjore sipas Ligjit për ndërmarrjet publike (ligji 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me vone dhe ne mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e ndërmarrjes, neni 4 i kreut III, që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, Bordi i përkohshëm i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me dt. 31 maj 2021, duke vepruar me kuorum dhe me votim njëzëri, ka vendosur si me poshtë:

### VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR 2020

*Ne pajtim me obligimin ligjor sipas legjislacionit në fuqi,*

*Konform Vendimit të tij dt 12 mars 2021, (nr prot 1910, dt 17.03.2021) për miratimin e Raportit vjetor konform nenit 31.1 të Ligjit për ndërmarrjet publike,*

*Bordi miraton Raportin Vjetor 2020, versioni i përshtatur konform kërkesave të Ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (Raporti).*

*Bordi autorizon Sekretarin e Korporatës që versionin e miratuar të Raportit t'ia dërgojë Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në Ministrinë e Ekonomisë si dhe Drejtorin Ekzekutiv Financiar për dorëzimin e të njëjtave në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar/Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës.*

*Vendimi hyn në fuqi menjëherë.*

**Shtojce:** Raporti Vjetor 2020, versioni sipas ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

I dërgohet:

1. Divizionit Financiar
2. Sekretaria e Ndërmarrjes
3. NjPMNP/ME
3. Arkivi KEK

Znj. Rrezarta Pllana:

Kryesues



Datë

31 maj 2021